

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XIX, nr. 5772
E enjte, 9 maj 2019
çmimi 0.40 €

Thaçi dhe Rama bisedojnë për hapje të plotë të kufirit Kosovë - Shqipëri

FAQE 2



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

AKTUALE

DINË GRABOVCI, AI QË DHA GJITHÇKA PËR LIRINË E KOSOVËS F.11

Lulëzim ETEMAJ

HARADINAJ: SHBA-ja DHE BE-ja NUK DUHET TA NDËRLIDHIN TAKSËN ME DIALOGUN F. 3

SLOGANI PËR ZGJEDHJET NË VERI: 'VOTA JUAJ. ARDHMËRIA JUAJ' F. 3

KOMANDANTI I GARDËS SË AJOVËS DEKOROHET ME MEDALJE PËR SHËRBIM VETËMOHUES F. 11



EKONOMI

ENERGJIA E RIPËRTËRISHME MBETET SFIDË NË KOSOVË F. 9

PAS MASËS PËR DRURIN, LIMAJ PARALAJMËRON MASA TË TJERA PËR T'I FUQIZUAR PRODHUESIT VENDORË F. 8

SPORT

REXHA, POROSI AISH-SKUADRËS: PIKËT MBESIN NË DRENAS F. 18



FLET PËR "EPOKËN E RE", ARMEND ZEMAJ F.4-5

Koalicioni qeverisës ka neglizhuar procesin integruar të Kosovës

Zëvendëskryetari i Komisionit për Integrim Evropian, Armend Zemaj, me rastin e shënimit të Ditës së Evropës, ka theksuar se me këtë konfigurim politik dhe këtë koalicion qeverisës ka neglizhencë të theksuar të procesit integruar të Kosovës. Në këtë intervistë dhënë për gazetën

"Epoka e re", ai ka thënë se sundimi i rendit dhe ligjit, aferat e mëdha korruptive, kritikata edhe nga vendet mike të BE-së për shpenzimet pa kontroll të parasë publike si dhe keqmenaxhimi dhe keqpërdorimi i fondeve të BE-së, kanë vështirësuar komunikimin institucional në mes të

punës së Komisionit për Integrim dhe Qeverisë së Kosovës, si dhe ministrive të linjës të cilat janë kompetente për proceset integruar të shtetit të Kosovës. Zemaj ka bërë thirrje për angazhim shtesë të të gjitha institucioneve në vend për zbatimin e MSA-së

Shtyhet afati për kthimin e borxhit prej 25 milionë eurosh ndaj 'Z-Mobile'

FAQE 5

Në takimin e Komiteti Ndërmarrës për Ndërmarrje Publike, që drejtohet nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, të mërkurën është arritur një pajtim në mes të ekzekutivit të Telekomit të Kosovës dhe përfaqësuesve të kompanisë "Dardafon.net" ("Z Mobile") që deri më 15 qershor të bëjnë një plan të pagesave për kthimin e borxhit prej 25



milione eurosh. Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Valdrin Lluka, ka thënë se kërkesa e Komitetit Ndërmarrës ishte që të krijohet një mundësi e re për të dyja palët që të punojnë në një planprogram të ri të pagesave. Qeveria e Kosovës është duke shqyrtuar mundësitë financiare për ta shpëtuar Telekomin e Kosovës nga falimentimi



O'Connell: Presioni i qytetarëve mund të sjellë ndryshime në Kosovë F.7

RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepcisht-Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegijbiznesi.com
info@kolegijbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Milorad Dodik për herë të parë në Shqipëri

TIRANË, 8 MAJ - Presidenti i Shqipërisë, Ilir Meta, ka zhvilluar të mërkurën një takim me drejtuesit e Presidencës së Bosnjë e Hercegovinës, Milorad Dodik dhe Shefik Xhaferoviq, të cilët ndodhen në Tiranë për të marrë pjesë në Samitin Brdo-Brione. "Kënaqësi ta takoja sot kryetarin e Presidencës së Bosnjë e Hercegovinës, Milorad Dodik dhe anëtarin e Presidencës, Shefik Xhaferoviq. Prania e tyre në Samitin e Brdo-Brijunit në Tiranë, kontribut i çmuar për një rajon të orientuar qartë ndaj vlerave evropiane. Shprehëm vullnetin e përbashkët për hapjen e ambasada

dave respektive në të dy vendet tona. Besimplotë për të ardhmen e shkëlqyer të marrëdhënies midis Shqipërisë dhe Bosnjë e Hercegovinës", ka shkruar presidenti Ilir Meta në një postim në Facebook.

Kjo është vizita e parë që kryetari i Presidencës së Bosnjë e Hercegovinës, Milorad Dodik, zhvillon në Shqipëri.

Kundër Dodikut dhe presidentit serb Aleksander Vuçiq është organizuar protestë nga dega e Lëvizjes Vetëvendosje në Tiranë, e cila ka eskaluar në përplasje me policinë e shtetit.

Dodik për media ka thënë se nuk i bën përshtypje protesta që

e shpall atë non grata në Shqipëri dhe se ai është në Tiranë për t'i përfaqësuar serbët e Bosnjë dhe Hercegovinës për t'i kryer detyrat sipas Kushtetutës.

Selia e Lëvizjes Vetëvendosje në Tiranë kishte paralajmëruar më herët zhvillimin e tubimit, por kur kanë zbritur në "teren" kanë hasur në kundërshtimin e forcave të rendit që e kanë cilësuar protestën të paligjshme.

"Vuçiq, Vuçiq, jashtë nga Shqipëria", ishte një nga brohoritjet që u dëgjua më tepër në protestë, ku u kundërshtua fort vizita e presidentit serb në Tiranë dhe u kërkua shpallja e tij "non-grata".



Thaçi dhe Rama bisedojnë për hapje të plotë të kufirit Kosovë - Shqipëri

Në takimin që kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, ka zhvilluar me presidentin e Kosovës, Hashim Thaçi, është biseduar për domosdoshmërinë e hapjes së plotë të kufirit Kosovë - Shqipëri dhe për krijimin e një hapësire shqiptare pa kufi

PRISHTINË, 8 MAJ - Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka takuar të mërkurën kryeministrin e Shqipërisë, Edi Rama, me të cilin ka biseduar për domosdoshmërinë e hapjes së plotë të kufirit Kosovë - Shqipëri dhe për krijimin e një hapësire shqiptare pa kufi.

Thaçi, i cili po qëndron në Tiranë, për të marrë pjesë në Samitin e Brdo-Brijunit, më herët ka takuar edhe presidentin e Shqipërisë, Ilir Meta. "Sapo zhvillova një takim me kryeministrin e Republikës së Shqipërisë, Edi Rama, ku biseduam për domosdoshmërinë e hapjes së plotë të kufirit Kosovë - Shqipëri dhe për krijimin e një hapësire shqiptare pa kufi, nën ombrellën euroatlantike. Në këtë takim ngritëm nevojën e korrigjimit të padrejtësive historike, duke

bashkuar faktorin shqiptar rreth sensibilizimit të së drejtës të bashkëngjitjes së Preshevës, Medvegjës dhe Bujanocit me territorin e Republikës së Kosovës", ka shkruar Thaçi në profilin e tij në "Facebook".

Presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, të mërkurën është prituri në takim edhe nga presidenti i Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta, para fillimit të Samitit Brdo-Brione.

Presidenti Thaçi ka falënderuar presidentin Meta për organizimin e këtij Samiti, i cili mbledh të gjithë liderët e rajonit, për të diskutuar për të ardhmen evropiane dhe për ta nxitur komunikimin për fqinjësi të mirë ndërmjet shteteve të Ballkanit Perëndimor.

Thaçi ka theksuar se ky samit



është një mundësi e radhës për të diskutuar për marrëdhëniet fqinjësore dhe integrimet euroatlantike.

"Pas Marrëveshjes së Prespës ndërmjet Maqedonisë së Veriut dhe Greqisë duhet ta shfrytëzojmë momentumin për t'i zgjidhur të gjitha mosmarrëveshjet në

Evropian. Vendet anëtare të procesit Brdo-Brione janë: Kroacia, Sllovenia, Maqedonia e Veriut, Shqipëria, Kosova, Serbia, Bosnjë e Hercegovina dhe Mali i Zi dhe ato përfaqësohen në nivel të kryetarëve të shteteve apo kryeministrave.

Thaçi. Në Tiranë, Thaçi po merr pjesë në takimin Brdo-Brioni - një nismë e ndërmarrë nga Kroacia dhe Sllovenia qysh në vitin 2013, me qëllim përshpejtimin e përafrimit të rajonit të Ballkanit me Bashkimin

Basha: Më 30 qershor nuk ka zgjedhje

TIRANË, 8 MAJ - Kryetari i PD-së, Lulzim Basha, u takua të mërkurën me demokratë në Korçë, ku dha disa mesazhe të rëndësishme për protestën kombëtare të 11 majit në Tiranë, për kauzën e zgjedhjeve të lira e të ndershme, për alternativën e PD-së. "Më 11 maj Korça dhe gjithë Shqipëria do të bashkohen në Tiranë. Beteja që kemi nisur do të përfundojë vetëm me shponjen

e qeverisë së krimit dhe triumfin e vlerave evropiane. E ardhmja e shqiptarëve është Evropa!", tha Basha.

Kreu i PD-së deklaroi se më 30 qershor nuk do të ketë zgjedhje. Ai paralajmëroi se nëse qeveria hyn në zgjedhje në situatën aktuale, do të ketë përballje në çdo qytet, fshat dhe lagje. "Data e zgjedhjeve të parakohshme nuk është e

parëndësishme, por zgjedhje me Edi Ramën. Shqipëria nuk do të ketë më një përdhunues serial të zgjedhjeve. Koka e sistemit me krimin duhet të shkojë para drejtës. Ai nuk meriton të marrë pjesë në zgjedhje por, të paktën, ne duhet të kërkojmë se ai nuk mund të jetë kryeministër as i zgjedhjeve lokale, as i zgjedhjeve të përgjithshme. Ndaj kjo është betejë jetike dhe

vendimtare për çdo shqiptar. Është e qartë se më 30 qershor nuk do të ketë zgjedhje lokale. Çdo tentativë për një proces fals, një proces të imponuar nga krimi do të përballet me qëndresë madhështore lagje më lagje, qytet më qytet. Zgjedhje farsë në Shqipëri më 30 qershor nuk do të ketë. Ndaj rruget e zgjedhjeve politike është e qartë", tha Basha.



Është mbajtur tryeza me temën "Dialogu Kosovë - Serbi pas takimit të Berlinit"

Haradinaj: ShBA-ja dhe BE-ja nuk duhet ta ndërlihin taksën me dialogun

Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, edhe një herë është shprehur kundër kushtëzimit të vazhdimit të dialogut Kosovë - Serbi. Në një debat të organizuar nga shoqëria civile për të ardhmen e këtij procesi, kryeministri u ka bërë thirrje ShBA-së dhe BE-së që vazhdimin e dialogut të mos e ndërlihin me heqjen e taksës që qeveria u ka vendosur produkteve serbe. Sipas tij, kjo qasje e ndërkombëtarëve është e gabueshme

cione", ka thënë Haradinaj. Ai ka përsëritur qëndrimin se është kundër lëvizjes së kufijve. "Koha na ka kushtuar të dyja palëve. Njëzet vjet kanë kaluar që nga përfundimi i luftës në Kosovë. Nuk kemi interes që të hapim sërish çështjen e Kosovës së 17 shkurtit. Kosovën e 17 shkurtit e ka mbyllur Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë. Ata që propozojnë marrëveshje me kufijtë janë duke tentuar që ta fusin Ballkanin në jostabilitet edhe dy për dekada", ka thënë Haradinaj, duke shtuar se platforma për bisedime e votuar në Kuvendin e Kosovës ndalon lëvizjen e kufijve. Edhe ambasadori i Zvicrës në Kosovë, Jean-Hubert Lebet, ka thënë se Samiti i Berlinit ka konfirmuar rëndësinë e palëve që të arrijnë një marrëveshje gjithëpërfshirëse dhe ligjore me

qëllim që të arrihet normalizimi i plotë i marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Më tej, ai ka deklaruar se Zvicra mbështet fuqimisht këtë qasje dhe mirëpret iniciativën e Gjermanisë dhe Francës. "Samiti i Berlinit ka konfirmuar rëndësinë e palëve në mënyrë që të arrihet një marrëveshje ligjore. Zvicra mbështet këtë qasje dhe mirëpret iniciativën e Gjermanisë dhe të Francës. Ndryshimi i kufijve nuk funksionon, nuk ka funksionuar asnjëherë. Nëse lëvizin kufijtë, arsyet e konfliktit nuk do të zgjidheshin. Nëse në Ballkan i preknë kufijtë, do të jeni në telashe. Është mirë që edhe Samiti i Berlinit e konfirmoi këtë", ka thënë diplomati zviceran. Ai ka thënë se për të pasur një marrëveshje përfundimtare të

besueshme procesi duhet të jetë transparent. "E dyta, kur marrëveshja bëhet me detyrim, edhe zgjidhjet e shpejta janë jostabile. Duhet besim mes palëve për ta arritur marrëveshjen dhe për këtë duhet kohë. Procesi të jetë gjithëpërfshirës dhe transparent", ka thënë Lebet. Kundër ndryshimit të kufijve është shprehur edhe kryetari i Partisë Progresive Demokratike në Kosovë, Nenad Rashiç. Ai ka thënë se ndarja apo korrigjimi i kufijve nuk është i mirë as për serbët e jugut dhe as për ata të veriut. "Samiti i Berlinit dha qëndrime të qarta se kjo nuk do të ndodhë. Në tërë këtë proces serbët e Kosovës janë shumë pak të përfshirë. Sa iu përket të drejtave dhe përfaqësimit të serbëve nuk po shoh përfaqësim autentik të serbëve të Kosovës", ka deklaruar Rashiç.

EPOKA E RE **Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 8 MAJ - Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka kërkuar nga partnerët ndërkombëtarë që të mos e ndërlihin vazhdimin e dialogut Kosovë - Serbinë me heqjen e taksës që Qeveria e Kosovës ua ka vendosur produkteve të Serbisë. Në tryezën "Dialogu Kosovë - Serbi pas takimit të Berlinit", të organizuar nga Instituti Demokratik i Kosovës (KDI), ai ka thënë se qasja e ShBA-së dhe BE-së, që t'i ndërlihin këto dy çështje, është e gabueshme. "Është gabim pozicioni, edhe i Uashingtonit, i evropianëve, i Berlinit dhe i Parisit t'ia pranojnë kushtin Serbisë: heqjen e tarifës për ta vazhduar dialogun", ka thënë Haradinaj. Ai ka thënë se dialogu Kosovë - Serbi për normalizimin e marrëdhënieve duhet të vazhdojë pa kushte. Haradinaj ka thënë se përfshirja e palëve të treta në këtë proces është e nevojshme. "Zgjidhja për marrëveshjen gjithëpërfshirëse merr kohë dhe përfshirja e palëve të treta është e nevojshme. Në Paris shpresojmë se të gjitha palët do të formulojnë

masa të reja. Nuk po bëhet fjalë vetëm për fatin e partive politike të Kosovës, por edhe të atyre që janë në pushtet, edhe të atyre që janë në opozitë. Kosova është shtëpia e të gjithë neve dhe është mirë që debati të kalojë edhe në tavolinën tuaj, e jo vetëm në tonën si parti politike e si institu-



Slogani për zgjedhjet në veri: 'Vota juaj. Ardhmëria juaj'



EPOKA E RE **Qendresa RAMA**

PRISHTINË, 8 MAJ - Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ka mbajtur të mërkurën mbledhjen e radhës të kryesuar nga kryetarja Valdete Daka. Në këtë mbledhje KQZ-ja mori disa vendime në kuadër të procesit të përgatitjes së zgjedhjeve të jashtëzakonshme për kryetar në komunat: Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Zveçan dhe Zubin Potok. KQZ-ja miratoi sloganin për zgjedhjet që do të mbahen në këto katër komuna: "Vota juaj. Ardhmëria juaj". Po në këtë mbledhje Komisioni

Qendror i Zgjedhjeve mori vendim për çregjistrimin e katër partive politike dhe ka shfuqizuar pezullimin për tri parti të tjera politike. Sipas vendimit të KQZ-së, partitë e çregjistruara janë: Partia e Ballit (PB), Partia e Fortë (PF), Aktivna GradanskaInicijativa (AGI) dhe Savez Nezavisnih Socijaldemokrata (SNSD). Këto parti politike nuk kanë dorëzuar të dhënat e ndryshimeve vjetore as pas afatit shtesë. Po ashtu, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve mori vendim për ta shfuqizuar pezullimin e tri partive politike: Partia

Demokratike e Unitetit (PDU), Crnogorska Liberalna Stranka (CLS) dhe Nova Partija Kosova (NPK). Sipas vendimit të KQZ-së, këto parti politike kanë dorëzuar përditësimin e të dhënave vjetore në afatin shtesë. Zgjedhjet e jashtëzakonshme për kryetar në komunat Mitrovicë e Veriut, Zubin Potok, Leposaviq dhe Zveçan do të mbahen më 19 maj. Katër kryetarët e këtyre komunave më 27 nëntor të vitit 2018 kanë dhënë dorëheqje, duke kundërshtuar vendimin e Qeverisë së Kosovës për vendosjen e taksës 100 për qind ndaj prodhimeve të importuara nga Serbia.

Flet për "Epokën e re", Armend Zemaj

Koalicioni qeverisës ka neglizhuar



Zëvendëskryetari i Komisionit për Integritim Evropian, Armend Zemaj, me rastin e shënimit të Ditës së Evropës, ka theksuar se me këtë konfigurim politik dhe këtë koalicion qeverisës ka neglizhencë të theksuar të procesit integruar të Kosovës. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se sundimi i rendit dhe ligjit, aferat e mëdha korruptive, kritikën edhe nga vendet mike të BE-së për shpenzimet pa kontroll të parasë publike si dhe keqpërnaxhimi dhe keqpërdorimi i fondeve të BE-së, kanë vështirësuar komunikimin institucional në mes të punës së Komisionit për Integritim dhe Qeverisë së Kosovës, si dhe ministrive të linjës të cilat janë kompetente për proceset integruar të shtetit të Kosovës. Zemaj ka bërë thirrje për angazhim shtesë të të gjitha institucioneve në vend për zbatimin e MSA-së

nuk janë akoma pjesë e BE-së. Andaj edhe festimi i saj është shumë më i zbehur kur elementi kryesor, që është lëvizja e lirë, nuk është arritur dhe qytetarët e Kosovës këtë ditë e festojnë me shumë si dëshirë sesa si realitet.

"Epoka e re": Komisioni, pjesë e të cilit jeni edhe ju, çfarë është duke bërë në këtë drejtim, në mënyrë që vendi ynë të shënojë përparim sa i përket agjendës evropiane në përgjithësi?

Zemaj: Komisioni është mekanizëm i cili përcjell legjislacionin që duhet të jetë në harmoni me acquiscommunitare, mbikëqyr përmbushjen e obligimeve për ekzekutivin që dalin nga agjenda evropiane dhe fushat e tjera specifike të cilat lidhen me procesin e plotë të afrimit dhe integritimit në BE. Fatkeqësisht, me këtë konfigurim politik dhe këtë koalicion qeverisës është parë një neglizhencë e theksuar dhe shumë dytësore e procesit integruar të Kosovës. Sundimi i rendit dhe ligjit, aferat e mëdha korruptive, kritikën edhe nga vendet mike të BE-së për shpenzimet pa kontroll të parasë publike si dhe keqpërnaxhimi dhe keqpërdorimi i fondeve të

EPOKA E RE Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 8 MAJ - Zëvendëskryetari i Komisionit për Integritim Evropian, Armend Zemaj, është shprehur i pakënaqur me dinamikën e agjendës evropiane të Republikës së Kosovës. Ai ka thënë se me këtë konfigurim politik është parë një neglizhencë dhe shumë dytësor procesi integruar i Kosovës. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Zemaj ka deklaruar se koalicioni qeverisës nuk e ka për interes integrimin e Kosovës në Bashkimin Evropian. Në këtë aspekt, ai ka thënë se roli i Kuvendit është minimizuar për

arsye të mosfunksionimit normal të punës dhe kryerjes së detyrave kushtetuese.

Zemaj ka theksuar se Kuvendi është në një gjendje inerte të funksionimit të tij, ka përzjerje të plotë të kompetencave dhe detyrave kushtetuese dhe, sipas tij, kjo gjendje është kontribues i keq që Kosova dhe qytetarët e saj edhe këtë vit të vazhdojnë të jenë të izoluar dhe larg nga rruga euroatlantike. "Ky tregues që sot Kosovën e gjënë të izoluar edhe në festën e BE-së vazhdon të jetë përgjegjësi për institucionet tona në këtë mashtrim optik, njëherësh tregon kompleksitetin që e ka BE-ja për të pranuar në gjirin e vet shtete dhe kombe të reja të cilat nuk janë ende pjesë e BE-së.

Andaj edhe festimi i Ditës së Evropës është shumë më i zbehur kur elementi kryesor, që është lëvizja e lirë, nuk është arritur dhe qytetarët e Kosovës e festojnë me shumë si dëshirë sesa si realitet", ka deklaruar Zemaj.

Ai ka folur edhe për procesin e zbatimit të MSA-së, për të cilin ka thënë se duhet angazhim shtesë, përgjegjësi më e madhe e të gjitha institucioneve në Kosovë në mënyrë që të ketë zbatim të plotë në interes të vendit dhe qytetarëve të Republikës së Kosovës. "Së fundmi ne kemi dhënë vërejtje dhe sugjerime përmbajtësore për Ministrinë e Integritimeve Evropiane për moszbatueshmërinë e plotë të masave zbatuese të MSA-së", ka theksuar Zemaj.

"Epoka e re": Z. Zemaj, edhe këtë vit Republika e Kosovës po feston Ditën e Evropës e izoluar dhe larg BE-së. A do të jetë 9 maji i këtij viti data e fundit, të paktën pa liberalizim të vizave?

Zemaj: Kur është caktuar si datë feste më shumë ka qenë simbolika e përafrimit me BE-në dhe treguesit e rrugës evropiane për Kosovën sesa një datë e cila të duket e imponuar duke treguar se ne jemi më shumë evropianë sesa vetë unioni. Ky tregues që sot Kosovën e gjen të izoluar edhe në festën e BE-së vazhdon të jetë përgjegjësi për institucionet tona në këtë mashtrim optik, njëherësh tregon edhe vetë kompleksitetin që ka vetë BE-ja për të pranuar në gjirin e vet shtete dhe kombe të reja të cilat

procesin integruer të Kosovës

Paramendojeni që agjenda evropiane ka muaj që ka kaluar në Komisionin për Integritet Evropiane, ndërsa edhe sot e kësaj dite nuk ka dalë në debat parlamentar për miratim. Ky është fakt që kjo qeveri dhe ky koalicion i cili e ka venë në anashkalim rolin dhe fuqinë e Kuvendit të Kosovës nuk e kanë për interes integrimin e Kosovës në BE.

"Epoka e re": Në këtë aspekt, a mund të paraqesin problem çështja e taksës dhe procesi i dialogut?

Zemaj: Taksa është problem i luftës së marrjes së meritave brenda koalicionit qeverisës, përfshirë këtu, fatkeqësisht, edhe presidentin e shtetit. Taksa është ndërmarrë pa asnjë marrëveshje me opozitën dhe pa asnjë sqarim të arsyetimit të këtij vendimi, qoftë edhe të mendimit të Kuvendit të Kosovës. Tani është vënë në dijeni të plotë nga deklaratat e tyre se vendosja e taksës është arsyetuar vetëm si vendim meritor ndaj shtetit të Serbisë, sepse edhe ne kemi menduar dhe kërkuar masa reciprociteti në sjelljen shtetërore të Serbisë ndaj Republikës së Kosovës. Si vendim mendoj se nuk i duhet dhënë rëndësi në procesin dialogues apo ta imponojmë rreth agjendës evropiane diçka e cila do t'i komplikonte edhe më shumë raportet me BE-në. Me një fjalë, Kuvendi është përjashtuar nga këto veprime dhe gjithçka është përkufizuar në interes elektorale të 'PAN-istve' dhe luftës së tyre të brendshme për dominim politik apo vendimmarrës.

"Epoka e re": Sa jeni të kënaqur me nivelin e zbatimit të MSA-së dhe cilat janë sfidat me të cilat po përballlet ky proces?

Zemaj: Janë dy aspekte të nivelit të zbatimit të MSA-së, detyrat dhe obligimet që dalin, por edhe prioritetet për zbatimin e masave të paracaktuara. Ka një mes të zbatimit dhe moszbatimit, andaj edhe vetëm një përqindje e caktuar që nuk arrin zbatueshmërinë e masave krijon komplikime dhe dobëson interesin tonë integruer dhe të bashkëpunimit me BE-në. Mendoj se duhet angazhim shtesë, përgjegjësi më e madhe e të gjitha institucioneve në Kosovë, që kjo marrëveshje kontraktuale të zbatohet plotësisht si interes i vendit dhe qytetarëve të Republikës së Kosovës. Së fundmi ne kemi dhënë vërejtje dhe sugjerime përmbajtësore për Ministrinë e Integritet Evropiane për moszbatueshmërinë e plotë të masave zbatuese të MSA-së.

BE-së, kanë vështirësuar edhe komunikimin tonë institucional në mes punës së Komisionit për Integritet dhe Qeverisë së Kosovës, si dhe ministrive të linjës të cilat janë kompetente për proceset integruer të shtetit të Kosovës.

"Epoka e re": Mendoni se Kuvendi i Republikës së Kosovës është duke e kryer rolin që i takon sa i përket agjendës evropiane? Cilat janë të metat në këtë drejtim?

Zemaj: Roli i Kuvendit është minimizuar për arsye të mosfunksionimit normal të punës dhe kryerjes së detyrave kushtetuese të Kuvendit të Kosovës. Pasqyrë e kësaj janë seancat e grumbulluara, mungesa e kuorumit nga shumica parlamentare dhe mospërgjegjësia e ministrave dhe qeverisë që të jetë e pranishme në seancat parlamentare. Kuvendi është në një gjendje inerte të funksionimit, ka përzjerje të plotë të kompetencave dhe detyrave kushtetuese. Andaj kjo gjendje është kontribuues i keq që Kosova dhe qytetarët e saj edhe këtë vit janë duke vazhduar të jenë të izoluar dhe shumë larg nga rruga euroatlantike.



Shtyhet afati për kthimin e borxhit prej 25 milionë eurosh ndaj 'Z-Mobile'

Në takim të Komiteti Ndërmarrje Publike, që drejtohet nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, të mërkurën është arritur një pajtim në mes të ekzekutivit të Telekomit të Kosovës dhe përfaqësuesve të kompanisë "Dardafon.net" ("Z mobile") që deri më 15 qershor të bëjnë një plan të pagesave për kthimin e borxhit prej 25 milionë eurosh. Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Valdrin Lluka, ka thënë se kërkesa e Komitetit Ndërmarrje Publike ishte që të krijohet një mundësi e re për të dyja palët që të punojnë në një planprogram të ri të pagesave. Qeveria e Kosovës është duke shqyrtuar mundësitë financiare për ta shpëtuar Telekomin e Kosovës nga falimentimi

**EPOKA
ERE** Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 8 MAJ - Komiteti Ndërmarrje Publike, që drejtohet nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, ka thirrur të mërkurën në takim punë Bordin dhe ekzekutivin e Telekomit të Kosovës, së bashku me përfaqësuesit e kompanisë "Dardafon.net" ("Z mobile"). Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Valdrin Lluka, ka thënë se qëllimi kryesor i këtij takimi ishte që të largohet presioni për inkasimin e mjeteve të vendosura nga arbitrazhi ndërkombëtar me vlerë prej 25.9 milionë eurosh përmes përmbauesve, që do ta bllokonte operimin e Telekomit të Kosovës dhe, njëkohësisht, negociatat e obliguara në mes të palëve. "Kërkesa jonë si komitet ishte që të krijohet një mundësi e re për të dyja palët që të punojnë në një planprogram të ri të pagesave, pa e ndërlikuar me

punën e negociatave dhe rezultatin final të tyre, pra mos të bëhet presion që negociatat të përfundojnë në favor të njëres palë", ka thënë Lluka. Ai ka theksuar se borxhi ndaj kompanisë në fjalë është vendosur nga arbitrazhi dhe është konfirmuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë dhe nga Gjykata e Apelit prandaj, sipas tij, në këtë moment edhe është i pakontestueshëm. "Pas një diskutimi nga të gjithë të pranishmit, palët u pajtuan që deri më 15 qershor të bëjnë një plan të pagesave ndaj këtij borxhi. Në këtë formë, grupet negociuese nuk do të vendosin temën e pagesës në diskutime. Telekomit i Kosovës, i mbështetur nga ky komitet dhe tërë Qeveria e Kosovës, së shpejti do të ketë qasje në kredi për ta implementuar kodin 383, për ta siguruar mirëmbajtjen e Telekomit dhe, njëherësh, për mirësimin e shërbimeve ndaj qytetarëve dhe për t'i bërë investimet e detyrueshme që të sigurohet mbarëvajtja e punës.

Në asnjë formë qeveria nuk do të lejojë që Telekomit të dështojë pasi që luan rol shumë të rëndësishëm për ekonominë e vendit dhe sigurinë kombëtare. Falënderoj të gjithë ata që ishin të pranishëm në këtë takim me rëndësi për të ardhmen e Telekomit të Kosovës", ka thënë ministri Lluka pas këtij takimi. Telekomit i Kosovës është kompani publike e transformuar në shoqëri aksionare, në të cilën operon telefonia fikse dhe ajo mobile "Vala". Operatori "Vala" ka mbi 1.2 milion konsumatorë në nivel vendi, po dikur njihej si një nga ndërmarrjet më fitimprurëse në vend. Për gjendjen e krijuar në këtë kompani, edhe Kuvendi i Kosovës ka ngritur një Komision Hetimor. Ndërkohë, për të martën e ardhshme, më 14 maj, është paralajmëruar edhe mbajtja e një seance të jashtëzakonshme parlamentare, ku do të shqyrtohet gjendja dhe kërkohet një zgjidhje eventuale për shpëtimin e kësaj kompanie nga falimentimi që ka mbi 2 500 punëtorë.

SBASHK-u përkrah garën e diturisë

PRISHTINË, 8 MAJ (ER) - Përveç partnerëve strategjikë, Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, përkrahje të vazhdueshme për zbatimin e Programit Nacional për Rininë po ofron edhe Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës. Koordinator i Nacional për

Kulturë, Rini dhe Sport në Qeverinë e Republikës së Kosovës, Rexhep Hoti, është takuar të mërkurën me kryetarin e SBASHK-ut, Rrahman Jasharaj, me të cilin ka biseduar për garën e diturisë e cila do të realizohet në kuadër të Programit Nacional për Rininë. "Gara e diturisë është pjesë e Programit Nacional për

Rininë, i paraparë për të gjithë nxënësit e Republikës së Kosovës. Jemi në përfundim të përgatitjeve për garën e diturisë e cila do të mbahet ditën e shtunë, më 11 maj 2019. Ju falënderoj për mbështetjen e dhënë për garën e Kreativitetit Kulturor dhe Mendimit Kritik ashtu edhe për garën e diturisë", ka thënë Hoti.



Ministrja Hoxha: Transparenca në komunikimin e procesit të integrimit rrit llogaridhënien



Ministrja e Integritimit Evropian, Dhurata Hoxha, ka thënë se informimi në kohë kontribuon në rritjen e llogaridhënies, sidomos në ato raste kur implementimi i ndonjë projekti të financuar nga BE-ja zvarritet apo dështon për mospërbushje të përgjegjësive institucionale qoftë të nivelit qendror apo lokal

EPOKA E RE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 8 MAJ - Komisioni për Integritime Evropiane, në bashkëpunim me Forumin për Transparençë Parlamentare, ka mbajtur të mërkurën takim lidhur me komunikimin në procesin e integrimit evropian në Kosovë, rolin e shoqërisë civile dhe medias, të cilin e ka kryesuar Blerta Deliu-Kodra.

Ministrja e Integritimit Evropian, Dhurata Hoxha, ka hapur diskutimin për procesin e komunikimit që synon informimin e publikut duke ofruar informata objektive dhe duke sfiduar perceptimet e gabuara rreth marrëdhënies Kosovë - BE, sidomos nevojën për informim të qytetarëve sa iu përket hapave konkretë që duhen përcjellë drejt anëtarësimit dhe cilat institucione janë përgjegjëse për reformat si sundimi i ligjit, fuqizimi ekonomik, apo promovimi i investimeve. "Sa i përket implementimit të reformave apo zbatimit të MSA-së dhe ERA-së, ne do të fokusohemi që niveli i zbatimit të monitorohet në mënyrë më kualitative dhe në terma konkretë, ashtu si raporti i BE-së për vendin", ka thënë ajo, duke shtuar se Ministria e Integritimit ka rol koordinues e të përkushtuar për transparencë. "Informimi në kohë kontribuon në rritjen e

llogaridhënies, sidomos në ato raste kur implementimi i ndonjë projekti të financuar nga BE-ja zvarritet apo dështon për mospërbushje të përgjegjësive institucionale qoftë të nivelit qendror apo lokal", ka theksuar ministrja Hoxha. Me rastin e shënimit të ditës së Evropës ajo ka treguar se Kosova ka lansuar edhe një kampanjë vetëdijesuese për informim më të mirë të publikut, për ngritjen e vetëdijes rreth hapave për anëtarësim në BE, për rëndësinë e MSA-së, rëndësinë e gjithëpërfshirjes dhe qytetarisë aktive për ta rritur llogaridhënien si dhe promovimit të vlerave të BE-së në vend.

llogaridhënies, sidomos në ato raste kur implementimi i ndonjë projekti të financuar nga BE-ja zvarritet apo dështon për mospërbushje të përgjegjësive institucionale qoftë të nivelit qendror apo lokal", ka theksuar ministrja Hoxha. Me rastin e shënimit të ditës së Evropës ajo ka treguar se Kosova ka lansuar edhe një kampanjë vetëdijesuese për informim më të mirë të publikut, për ngritjen e vetëdijes rreth hapave për anëtarësim në BE, për rëndësinë e MSA-së, rëndësinë e gjithëpërfshirjes dhe qytetarisë aktive për ta rritur llogaridhënien si dhe promovimit të vlerave të BE-së në vend.

Ambasadori i Gjermanisë kërkon zbatimin e reformave të MSA-së

Me rastin e shënimit të Ditës së Evropës, të mërkurën në Drenas ministrja e Integritimit Evropian, Dhurata Hoxha, ambasadori i Gjermanisë, Christian Heldt, kryetari i komunës, Ramiz Lladrovci dhe Alba Boshnjaku, bursiste e Young Cell Scheme, kanë mbajtur debat me nxënësit e kësaj komune, me temë "Promovimi i vlerave të BE-së, rëndësia e gjithëpërfshirjes në procesin integruar".

Ministrja Hoxha ka bërë me dije se Komuna e Drenasit është përzgjedhur për të diskutuar për promovimin e vlerave të BE-së meqenëse kjo komunë ka vendosur standard të mirë për barazinë gjinore duke punësuar numër të barabartë të grave dhe të burrave në struktura udhëheqëse. Duke iu referuar të kaluarës tonë si vend, por edhe rajonit, ministrja Hoxha ka theksuar se rruga më e sigurt drejt prosperitetit, paqes dhe zhvillimit të qëndrueshëm është anëtarësimi i Kosovës në Bashkimin Evropian. Sipas ministres, ky është një proces i gjatë që kërkon përkushtim. "Vlerat dhe parimet e BE-së

duhen çmuar dhe duhen arritur me përkushtim nga secili institucion i nivelit qendror, por edhe të atij lokal, duke përfshirë edhe qytetarët aktivë dhe dëgjimin e shqetësimeve të rinjve tanë për llogaridhënie më të madhe në rrugën tonë të BE-së", është shprehur Hoxha, duke shtuar se kërkohet përkushtim i veçantë për sistemin arsimor, zhvillimin ekonomik, inovacionin e ndërmarrësin dhe aftësimin e të rinjve që t'i përballojnë kërkesat e tregut të punës.

Ndërsa ambasadori i Gjermanisë në Kosovë, Christian Heldt, ka vlerësuar angazhimin për procesin integruar, por ka kërkuar t'i kushtohet vëmendje zbatimit të reformave, MSA-së, ERA-s, luftimin të korrupsionit si dhe çështjeve të rinjve si punësimi, aftësimi dhe përkrahja institucionale. Kurse kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci, e ka quajtur të dobishëm këtë diskutim, duke vlerësuar të arriturat për barazinë gjinore, transparencën, mbrojtjen e ambientit dhe të tjera.

Rinia Demokratike në Prishtinë me ekspozitë vë në pah dështimet në kryeqytet

PRISHTINË, 8 MAJ (ER) - Rinia Demokratike e Kosovës, Dega në Prishtinë, pranë objektit të komunës ka shfaqur të mërkurën ekspozitë për gjendjen e rëndë infrastrukturore dhe të çështjeve problematike në kryeqytet. "Ekspozita pasqyron gjendjen kaotike në kryeqytet. Duke parë se komuna nuk po investon në projekte konkrete, nuk po i mirëmban rrugët dhe trotuarët, nuk ka strategji për lehtësimin e komunikimit të dendur, mungojnë parkingjet, mungojnë parqet, mungon

edhe ndriçimi, rinia e Prishtinës nuk mund të qëndrojë indiferente", ka thënë Vivianit Fejza, kryetar i Degës së RDK-së, Dega në Prishtinë. Ai ka theksuar se, ndonëse ka shumë gjëra elementare që mungojnë, Prishtina vazhdon të ketë tepriçë buxhetore çdo vit. "Kujtojmë se kryeqyteti në vitin 2018 nuk i ka shfrytëzuar 23 milionë euro. Shpendi vetëm fizikisht mund të jetë në Prishtinë, sepse me mendje e me zemër është në Bruksel", ka theksuar Fejza.



Ambasadori i Britanisë në Kosovë, Ruairi O'Connell, ka marrë pjesë në debatin e organizuar nga Lëvizja FOL

O'Connell: Presioni i qytetarëve mund të sjellë ndryshime në Kosovë

Presioni i qytetarëve është e vetmja mënyrë për t'i detyruar politikanët të marrin masa për ta përmirësuar gjendjen në Kosovë. Kështu ka deklaruar të mërkurën ambasadori i Britanisë, Ruairi O'Connell, në debatin e organizuar nga Lëvizja FOL. Ai u ka bërë thirrje qytetarëve ta shtojnë presionin për të kërkuar llogaridhënie dhe ndryshime përmes votës. O'Connelli ka thënë se Kosova duhet t'i dëgjojë miqtë e saj, në të kundërtën, sipas tij, nëse bashkësia ndërkombëtare humbet durimin, do të ishte dëm shumë i madh për Kosovën



**EPOKA
ERE** **Faton DERMAKU**

PRISHTINË, 8 MAJ - Ambasadori i Britanisë së Madhe në Kosovë, Ruairi O'Connell, të mërkurën u ka bërë thirrje qytetarëve të Kosovës ta shtojnë presionin për të kërkuar llogaridhënie dhe ndryshime përmes votës. Ai ka thënë se Kosova duhet t'i dëgjojë miqtë e saj, në të kundërtën, sipas O'Connellit, nëse bashkësia ndërkombëtare humbet durimin, do të ishte dëm shumë i madh për Kosovën. "Kosova ka nevojë për përkrahjen e vazhdueshme të bashkësisë ndërkombëtare dhe nëse kjo humbet, do të ishte problem jetik për Kosovën.

Qytetarët mund të bëjnë ndryshimin. Ne nuk kemi të drejtë vote këtu. Presioni i qytetarëve është e vetmja mënyrë për t'i detyruar politikanët të marrin masa", ka deklaruar ambasadori O'Connell në debatin me temë "Fenomeni i konfliktit të interesit në Kosovë, rekrutimi i zyrtarëve të lartë publikë dhe nepotizmi" të organizuar nga Lëvizja FOL. Ambasadori O'Connell ka paralajmëruar se nëse institucionet vazhdojnë keqmenaxhimin e parasë publike, nepotizmin dhe punësimet partiake, bashkësia ndërkombëtare do ta shqyrtojë përkrahjen për Kosovën. "Nëse qytetarët e Kosovës vazhdojnë të votojnë për partitë që shkelin

ligje, që përfshijnë kriminelë, që keqpërdorin gjërat, që punësojnë njerëz në bazë të partisë dhe njerëzit nuk reagojnë, ne nuk kemi çfarë të bëjmë. Por do të vijë dita kur ne do të kemi një vendim të vështirë për përkrahjen tonë për Kosovën", është shprehur O'Connell.

Ai ka thënë se 20 vjet pas luftës Kosova duhet të marrë vendime të qarta se si ta vazhdojë rrugën e saj, t'i dëgjojë sugjerimet dhe ta

pranojë ndihmën e bashkësisë ndërkombëtare. "20 vjet pas luftës ka ardhur koha për të reflektuar ku jemi dhe ku do të shkojë Kosova. Ne si bashkësi ndërkombëtare kemi investuar shumë, jo vetëm se ka qenë e drejtë, obligim moral, por ka qenë në interesin e shumë partnerëve në Kosovë për të pasur një shtet të suksesshëm që ofron të ardhme të ndritshme për qytetarë dhe ku luftohet krimi dhe korrupsioni. Nëse nuk do të kishte sukses Kosova, ne do të kishim probleme, gjithashtu", ka deklaruar O'Connell, duke shtuar se dy dekada pas luftës ka ardhur koha për marrjen e masave konkrete dhe për të pasur rezultate.

Sa i përket procesit të rekrutimit, ai ka thënë se ka pasur rezultate meqenëse institucioneve të Kosovës, përkatësisht qeverisë dhe Kuvendit, u është ofruar mundësia për ta përdorur kompaninë britanike për procesin e rekrutimit. "Deri tanë janë kryer 47 procese, prej tyre 23 kanë pasur rezultate të mira. Kjo tregon se kur ka vullnet nuk mungojnë rezultatet", ka theksuar O'Connell, duke shtuar se procesi i rekrutimit duhet të zhvillohet mbi bazën e meritës. "Nëse vazhdojnë tentimet për të ndërhyrë ne nuk do ta vazhdojmë përkrah-

jen në procesin e rekrutimit sepse nuk ka sens", ka thënë O'Connell.

Ambasadori Ruairi O'Connell ka deklaruar se Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) është i koklavitur dhe kjo tregon për gjendjen e sistemit në Kosovë. Ai ka folur edhe për procesin e rekrutimit më Agjencinë Kosovare për Verifikim të Pronave ku ka qenë anëtar i bordit, duke thënë se është ndarë tepër i zhgënjyer me ecurinë e funksionimit të kësaj agjencie. "Nuk dua të trajtohem si budalla në një agjenci ku nuk dihet se a mund të ketë sukses dhe se a mund të shkojë me ata njerëz", ka theksuar diplomati britanik. Ai ka thënë se ndaj këtyre dukurive, përveç ndërkombëtarëve, duhet të reagojnë më shumë qytetarët e Kosovës. "Unë nuk do ta marr asnjëherë rolin të vendos për Kosovën. Ju duhet ta bëni atë", është shprehur O'Connell. Ai ka thënë se Britania nuk do të ndalet së investuari për ta ndihmuar Kosovën. "Kemi menduar të investojmë në sektorë specifike dhe nëse ka mohime flagrante të rekomandimeve atëherë duhet të vendosim për të shpenzuar apo jo parane britanike në Kosovë", ka deklaruar ambasadori O'Connell.



Kirurgjia Torakale fillon aplikimin e metodave bashkëkohore për operim

PRISHTINË, 8 MAJ (ER) - Në Kirurgjinë Torakale të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës është aplikuar metoda më e re kirurgjike, video-kirurgjike "Vats Uniportal". Operacioni është kryer me sukses të plotë nga stafi vendor, nën drejtimin

e drejtorit të Kirurgjisë Torakale, dr. Saudin Maliqi. Kjo metodë kirurgjike konsiston në operacion pa hapje të krahorit, e përcjellë me video-kirurgji. Muaj më parë për këtë lloj intervenimi në Prishtinë ishin kirurgët më eminentë për

trajnimin e stafit mjekësor. Kirurgjia Torakale ka për objektiv avancimin e ekspertëve tanë, duke i trajnuar jashtë vendit, në mënyrë që të kryhen të gjitha ndërhyrjet kirurgjike bashkëkohore edhe në Kosovë.



Pas masës për drurin, Limaj paralajmëron masa të tjera për t'i fuqizuar prodhuesit vendorë

PRISHTINË, 8 MAJ (ER) - Zëvendëskryeministri i Kosovës, Fatmir Limaj, ka thënë se Qeveria e Kosovës që nga dita e parë e marrjes së detyrës e ka vendosur në fokus të saj mbrojtjen dhe mbështetjen e prodhuesve vendorë. Limaj ka thënë se vendimi i fundit i qeverisë, i propozuar nga ministri i Tregtisë dhe Industrisë, Endrit Shala, për ndalimin e eksportimit të masës drunore si lëndë e papërpunuar nga Kosova në drejtim të vendeve të tjera, është në funksion të mbrojtjes së prodhuesve vendorë.

Kjo masë, numri dy i Qeverisë së Kosovës ka thënë se do t'i kontribuojë ruajtjes së pyllit. "Qeveria e Kosovës që nga dita e parë e marrjes së detyrës në qendër të vëmendjes e ka vendosur mbrojtjen dhe mbështetjen e prodhuesve vendorë. Edhe vendimi i fundit i Qeverisë, i propozuar nga ministri i Tregtisë

dhe Industrisë, Endrit Shala, për ndalimin e eksportimit të masës drunore si lëndë e papërpunuar nga Kosova në drejtim të vendeve të tjera, është në funksion të mbrojtjes së prodhuesve vendorë. Kjo masë është bërë për kohësisht për shkak se po e dëmton rëndë sektorin e përpunimit të drurit në vendin tonë. Në këtë formë ne do ta ruajmë pyllin nga prerjet ilegale në Kosovë, qoftë për masë drunore teknike dhe për masën drunore dru zjarri", ka thënë Limaj.

Ai ka theksuar se si Qeveri e Kosovës janë të vendosur t'u ndihmojnë, për aq sa është e mundur, të gjithë prodhuesve vendorë, pa dallim. "Fuqizimi i prodhuesve vendorë nënkupton rritje të buxhetit dhe hapje të reja të vendeve të punës për qytetarët tanë. Janë edhe një sërë masash të cilat do të merren me qëllim të stimulimit të prodhuesve vendorë", ka thënë Limaj.



ATK-ja, në bashkëpunim me Akademinë e Drejtësisë, realizoi trajnim për gjyqtarët dhe ekspertët gjyqësorë



PRISHTINË, 8 MAJ (ER) - Administrata Tatimore e Kosovës (ATK), në bashkëpunim me Akademinë e Drejtësisë, kanë organizuar trajnim dyditor për gjyqtarët dhe ekspertët gjyqësorë me temën "Interpretimi i legjislacionit tatimor në Kosovë". Në këtë trajnim nga përfaqësuesi i ATK-së u trajtuan temat: Administrata Tatimore dhe procedurat; Tatimi mbi Vlerën e Shtuar; Tatimi në të Ardhurat Personale; Tatimi në të Ardhurat e Korporatave; Transferimi i çmimit; dhe Marrëveshjet për

eliminimin e tatimit të dyfishtë. "Qëllimi i mbajtjes së këtij trajnimit ishte avancimi i njohurive të gjyqtarëve dhe bashkëpunëtorëve profesionalë lidhur me aplikimin dhe zbatimin e legjislacionit tatimor në Kosovë, gjegjësisht procedurat e Administratës Tatimore të Kosovës, Tatimin mbi Vlerën e Shtuar, Tatimin në të Ardhura Personale, Tatimi në të Ardhura të Korporatave, Transferimin e çmimit dhe Marrëveshjet për Eliminimin e Tatimit të Dyfishtë, duke përfshirë edhe të gjitha

tatimet e mbajtura në burim, si: Tatimi në Paga, Kontributet Pensionale etj. Për të gjitha temat e lartcekura janë pasqyruar edhe shembuj praktikë për trajtimin e tyre", është thënë në njoftimin e ATK-së.

Gjatë këtij trajnimit, pjesëmarrësit parashtruan pyetje të ndryshme lidhur me temat e prezantuara, si dhe pyetje të tjera lidhur me legjislacionin tatimor. Për të gjitha pyetjet e parashtruara nga pjesëmarrësit janë ofruar përgjigje adekuate nga prezantuesi i trajnimit.

AKP-ja shpalli rezultatet e shitjeve përmes likuidimit nr. 46

Për 113 asete sa ishin në shitje konkurruan 99 ofertues, ndërsa vlera e tërësishme e ofertave më të larta ishte 5,048,057 euro.

PRISHTINË, 8 MAJ (ER) - Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) të mërkurën në ceremoninë e hapjes së ofertave të shitjeve nr. 46 përmes metodës së likuidimit shpalli çmimet më të larta të ofruara për asetet e ndërmarrjeve shoqërore që ishin në dispozicion për shitje. Për 113 asete sa ishin në shitje konkurruan 99 ofertues, ndërsa vlera e tërësishme e ofertave më të larta ishte 5,048,057 euro. "Dorëzimi i ofertave nga investitorët, hapja e ofertave dhe publikimi i rezultateve u bënë në mënyrë transparente, para përfaqësuesve të mediave, përfaqësuesve të Odës

Ekonomike të Kosovës dhe Odës së Avokatëve të Kosovës si dhe investitorëve të pranishëm", është thënë në njoftimin për media të AKP-së. Agjencia Kosovare e Privatizimit është organ i pavarur i themeluar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës dhe është e shtrirë dhe vepron në të gjithë territorin e vendit. Agjencia ka mandatin dhe autoritetin për shitjen ose bartjen e këtyre ndërmarrjeve dhe asetëve investitorëve privatë-blerësve, ose likuidimin e tyre, gjithnjë përmes një procesi të hapur, transparent, konkurrues dhe pa vonesa.



Mbahet konferenca "E ardhmja dhe sfidat e energjisë së ripërtëritshme në Kosovë"

Energjia e ripërtëritshme mbetet sfidë në Kosovë



Drejtori ekzekutiv i Klubit të Prodhuesve, Astrit Panxha, ka thënë se një ndër sfidat më të mëdha të prodhuesve është mungesa e vazhdueshme e furnizimit me energji elektrike, e cila po u shkakton bizneseve humbje të mëdha. Ndërkaq kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës, Berat Rukiqi, ka theksuar se për prodhimin e energjisë duhen të merren parasysh tri elemente: siguria furnizimi apo stabiliteti, kostoja dhe ruajtja e ambientit

mënyrat e financimit të këtij sektori dhe se ku qëndron rëndësia e financimit të këtij sektori nga institucionet financiare në Kosovë.

Astrit Panxha, drejtor ekzekutiv i Klubit të Prodhuesve, u shpreh se një ndër sfidat më të mëdha të prodhuesve është mungesa e vazhdueshme e furnizimit me energji elektrike, e cila po u shkakton bizneseve humbje të mëdha. Sipas Panxhës, liberalizimi i tregut të energjisë duhet të shtyhet edhe për pak, pasi që shumë operatorë ekonomikë nuk janë të gatshëm të përballen me këtë proces. Po ashtu, ai ka theksuar se çmimi i tarifës nxitëse duhet ta reflektojë çmimin e investimeve në mënyrë që të mos dekurajohen investitorët potencialë.

Kryetari i OEK-ut, Berat Rukiqi,

ka thënë se diskutimet e tilla duhet të vazhdojnë edhe në të ardhmen, për arsye se gjatë këtyre viteve po shtohen diskutimet për burimet jokonvencionale të energjisë. Sipas tij, për prodhimin e energjisë duhen të merren parasysh tri elemente: siguria furnizimi apo stabiliteti, kostoja dhe ruajtja e ambientit. Ai ka theksuar se duhet të vazhdohet me tarifën nxitëse dhe ka kërkuar nga institucionet financiare që ta rrisin përkrahjen e investimeve në këtë sektor.

Arbnor Kastrati nga Shoqata për Energji të Ripërtëritshme ka kërkuar nga institucionet qeveritare që të jenë më të përgjegjshme në deklaratat publike të tyre. Ai ka shtuar se institucionet duhet t'i shohin bizneset si partnerë dhe bashkëpunëtorë për përpilimin

e strategjive të tyre.

Ndërkaq përfaqësuesit e BERZH-it dhe IFC-së, Vlora Avdiu-Burani dhe Visar Perani, diskutuan për mënyrat e financimit të projekteve të cilat zhvillojnë sektorin e energjisë së gjelbër, ku BERZH-i vetëm gjatë vitit të kaluar ka investuar mbi 60 milionë euro, ku 60 për qind e këtyre fondeve janë investuar në energjinë e gjelbër. Ndërsa IFC si pjesë e Bankës Botërore, energjinë e ka prioritet, e posaçërisht energjinë e ripërtëritshme. Të pranishëm ishin përfaqësues të Zyrës së Rregullatorit për Energji, përfaqësues nga Shoqata për Energji të Ripërtëritshme e Kosovës, përfaqësues të biznesit si dhe përfaqësues nga institucionet financiare vendore dhe ato ndërkombëtare.

**EPOKA
ERE** Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 8 MAJ - Klubi i Prodhuesve të Kosovës (KPK) së bashku me Odën Ekonomike të Kosovës (OEK) ka organizuar të mërkurën konferencën "E ardhmja dhe sfidat e energjisë së ripërtëritshme në Kosovë" e cila ka adresuar temat të cilat ndikojnë në të ardhmen e

energjisë së ripërtëritshme dhe zhvillimin e këtij sektori. Gjatë konferencës u diskutua për tarifën nxitëse, si një ndër stimujt kryesorë të investimit në prodhimin e energjisë elektrike nga burimet e ripërtëritshme. Po ashtu, u shqyrtua edhe korniza ekzistuese rregullative për promovimin e projekteve të energjisë nga burimet e ripërtëritshme në Kosovë,

Aftësimi profesional, çelës i zbutjes së papunësisë në vend

Reçica ka theksuar se aftësimi profesional dhe orientimi i të rinjve në karrierë janë të domosdoshme dhe çelës i zbutjes së papunësisë në vend

PRISHTINË, 8 MAJ (ER) - Ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale, Skender Reçica, ka pritur të mërkurën në takim një delegacion nga Shteti i Iowas, ShBA, kryesuar nga presidenti i kolegjit DMACC (Des Moines Area Community College), Rob Denson. Ministri Reçica ka shprehur falënderimet për mbështetjen e vazhdueshme të ShBA-së për Republikën e Kosovës në të gjitha fazat e shtetndërtimit dhe zhvillimit.

Ai e ka njoftuar Densonin rreth problemeve që Kosova po përballlet sa i përket papunësisë si dhe mungesës së punëtorëve të kualifikuar, sipas nevojave të

tregut të punës. Reçica ka theksuar se aftësimi profesional dhe orientimi i të rinjve në karrierë janë të domosdoshme dhe çelës i zbutjes së papunësisë në vend.

Në anën tjetër, Denson ka ofruar mbështetjen e plotë të ShBA-së për ta ndihmuar Kosovën në çështjet për të cilat u diskutua rreth punësimit dhe aftësimit profesional. Pas takimit, ministri Reçica dhe delegacioni nga Iowa vizituan Qendrën e Aftësimit Profesional në Prishtinë për ta parë nga afër punën që bëhet në shërbim të punëkërkuësve, të cilët zgjedhin këtë qendër për t'i ndjekur trajnimet profesionale në profilet që ofrohen aty.





Hetuesit policorë interesohen për materialet e krimeve të luftës në Shtime

SHTIME, 8 MAJ (ER) - Zyrtarë dhe hetues të Policisë të Kosovës (PK) për hetimet e krimeve të luftës, me autorizim të Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, kanë

qëndruar në Komunën e Shtimes, me ç'rast janë pritur nga kryetari i kësaj komune, Naim Ismajli dhe nënkryetari Rrahman Jakupi. Qëllimi i takimit ishte diskutimi i

mundësive të grumbullimit të materialeve dhe fakteve për krimet e kryera nga forcat serbe gjatë luftës 1998-1999 në Komunën e Shtimes, në veçanti për masakrën e Reçakut.

Lladrovci jep mirënjohje 'postmortem' për Hashim Shalën

Drenas, 8 maj (ER) - Kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci, ka dhënë mirënjohje "postmortem" për rapsodin Hashim Shala me motivacionin: "Për kontributin e dhënë në kultivimin e këngës shqipe". Mirënjohjen e kanë pranuar Mirilind Shala dhe Naim Shala, djemtë e këngëtarit Hashim Shala. Hashim Shala ka lindur në vitin

1933 në fshatin Vërbovc të Komunës së Drenasit. Rapsodi Shala për shumë vite me radhë ishte mbledhës i folklorit shqiptar në anën e Drenicës, ka krijuar dhe kultivuar zhanrin e muzikës burimore folklorike dhe ishte pjesëmarrës në shumë festivale të muzikës burimore. Rapsodi Shala ka ndërruar jetë më 19 shtator të vitit të kaluar në moshën 85-vjeçare.



Komuna e Vitisë radhitet ndër komunat më të mira në Kosovë



VITË, 8 MAJ (ER) - Komuna e Vitisë ka arritur të radhitet ndër tri komunat me performancën më të mirë në nivel vendi në Indeksin e Konkurrueshmërisë së Komunave (IKK) 2019. Ky indeks është krijuar për ta matur performancën e qeverisë lokale drejt krijimit të një mjedisi të shëndoshë afarist. Një gjë e tillë është bërë me dije gjatë prezantimit të këtij raporti në Prishtinë. Gjithashtu, në këtë raport janë prezantuar gjetjet e anketës me 3 350 biznese nga 38 komunat e Kosovës. Në bazë të këtyre gjetjeve është arritur deri te vlerësimi i qeverisjes lokale në bazë të ambientit përkrahës

për zhvillim të bizneseve. Komuna e Vitisë është radhitur e dyta në nivel vendi në nënindeksin e transparencës i cili matë transparencën e komunës në lidhje me bizneset. Duke u bazuar në këtë raport, Komuna e Vitisë ka marrë edhe vendin e dytë në këta nënindekse: kosto kohore, taksat dhe tarifat. Kurse në bazë të IKK-së, peshuar në bazë të politikave publike, Vitia ka marrë vendin e dytë. Përndryshe, pothuajse në të gjithë nënindekset e këtij vlerësimi Komuna e Vitisë është radhitur ndër komunat më të mira në Kosovë.

Komuna e Prishtinës shqipton gjoba ndaj disa kompanive të taksive

PRISHTINË, 8 MAJ (ER) - Komuna e Prishtinës ka njoftuar se Drejtoria e Inspeksionit ka vërejtur se disa prej kompanive të taksive kanë më shumë vetura në qarkullim sesa leje nga organi përkatës. Kjo komunë ka theksuar se për të gjitha këto kompani të taksive ka shqiptuar gjoba. Në këtë kontekst, komuna e drejtuar nga Shpend Ahmeti ka bërë me dije se do të rritet

kontrolli në raport me kompanitë e taksive në kryeqytet. "Nga inspektimet e vazhdueshme në terren, Drejtoria e Inspeksionit ka vërejtur se disa prej kompanive të taksive shpeshherë kanë më shumë vetura në qarkullim sesa leje nga organi përkatës. Deri tani, kudo që janë hasur raste të tilla, janë shqiptuar gjoba. Tash e tutje kontrolli do të rritet në këtë drejtim dhe masat që do t'i

ndërmarrin inspektorët do të jenë më të ashpra. Duke e pasur parasysh kërkesën e vazhdueshme për hapjen e kompanive të reja të taksive, njoftojmë kompanitë aktuale që t'u përmbahen rregullave, në të kundërtën rrezikojnë t'i humbin licencat. Nuk mund të operohet në kryeqytet me leje nga komunat e tjera, aq më pak pa leje fare", ka njoftuar Komuna e Prishtinës.



Komandanti i Gardës së Ajovës dekorohet me medalje për shërbim vetëmohues

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 8 MAJ - Nën përkujdesjen e kryeministrit të Republikës së Kosovës, Ramush Haradinaj, në Ministrinë e Mbrojtjes është organizuar të mërkurën një pritje shtetërore për nder të komandantit të Gardës Kombëtare të Ajovës së ShBA-së, gjeneralmajor Timothy Orr, ku kanë marrë pjesë përfaqësues institucionalë, deputetë, ministra, përfaqësues diplomatikë të akredituar në Kosovë dhe ushtarakë. Me këtë rast, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, ka folur për rëndësinë e partneritetit ndërmjet FSK-së dhe Gardës Kombëtare të Ajovës si dhe për kontributin e gjeneralit Orr në këtë bashkëpunim. "Që nga themelimi i programit të partneritetit shtetëror në vitin 2011, në saje të vizionit strategjik dhe përkushtimit strategjik të gjeneralit Orr, FSK-ja është zhvilluar si forcë më profesionale dhe e gatshme për t'iu shërbyer qytetarëve të vet. Gjeneral Orr, unë jam shumë mirënjohës për përpjekjet e jashtëzakonshme të ushtarëve të aviacionit të Gardës Kombëtare të Ajovës që kanë bërë, nën udhëheqjen tuaj, për zhvillimin e zyrtarëve, nënoficerëve dhe ushtarëve të FSK-së. Sot jemi më të fortë dhe më profesionalë. Faleminderit!", ka thënë gjenerallejtënant Rama.

Në fund gjeneral Rama e ka dekoruar gjeneralin amerikan Timothy Orr me medaljen për shërbim vetëmohues. Ndërsa gjenerali Orr, i entuziazmuar nga atmosfera e ngrohtë e krijuar për nder të tij, ka deklaruar: "Jam shumë i lumtur që jam këtu dhe jam shumë krenar që po nderohem me medalje nga FSK-ja. Ne në veçanti kemi zgjedhur Kosovën nga 18 vende. Këtu po shoh anëtarët e forcave të mia dhe të FSK-së. E keni përkushtimin tim dhe do të vazhdojmë t'ju ndihmojmë në këtë fushë".



Komandanti Orr i jep medalje komandantit të FSK-së

Edhe komandanti i Gardës Kombëtare të Ajovës i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, gjeneralmajor Timothy Orr, ka dekoruar me medalje për shërbim të shquar, komandantin e Forcës së Sigurisë të Kosovës, gjenerallejtënant Rrahman Rama. Medalja amerikane për komandantin e FSK-së ka këtë motivacion: "Për performancë të shkëlqyeshme në

Programin e Partneritetit Shtetëror ndërmjet Kosovës dhe Ajovës. Që nga marrja e detyrës gjenerallejtënant Rrahman Rama punoi pa u lodhur për t'i avancuar marrëdhëniet strategjike të Gardës Kombëtare të Ajovës me Forcën e Sigurisë së Kosovës dhe Shtetit të Ajovës me Republikën e Kosovës. Përkushtimi i tij dhe mbështetja e palëkundshme e

Programit të Partneritetit Shtetëror, veçanërisht Gardës Kombëtare të Ajovës, janë në përputhje me nivelin më të lartë të shërbimit ushtarak. Veprimet dhe angazhimi i gjenerallejtënant Rrahman Ramës pasqyrojnë një kredi të madhe ndaj tij, Gardës Kombëtare të Ajovës, Republikës së Kosovës dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës".



Në 20-vjetorin e rënies

Dinë Grabovci, ai që dha gjithçka për lirinë e Kosovës

Lulëzim ETEMAJ

Para 20 vjetësh, kushërinjtë dhe bashkëfshatarët e mi, të Saradranit të Istogut, me rëniën e tyre, me gjakun e tyre të derdhur për liri, dëshmuuan edhe një herë fuqishëm dashurinë e tyre për Kosovën, për të ardhmen e saj të lirë, të cilën po e jetojmë dhe gëzojmë sot. Në mesin e tyre gjendet edhe i shumëpërkushtuari, njeriu që mbi çdo gjë kishte vënë lirinë dhe pavarësinë e Kosovës, Dinë Grabovci, vëllai i të cilit, Adem

Grabovci, ishte i burgosur politikë 3 herë radhazi, njëherësh ishte edhe njëri nga pesë nismëtarët e Aksionin të Pajtitimit të Gjaqeve në vitin 1990 në Kosovë dhe më pas njëri nga themeluesit e UÇK-së. Në vitin 1990 shtëpia e Dinë Grabovcit ishte shndërruar në njërën nga pikëtakimet kryesore të ish-të burgosurve politikë të kësaj ane. Aty ato ditë hartoheshin planet dhe ndaheshin detyrat rreth organizimit të demonstratave në Pejë; aty kthehej natën vonë apo dhe mbas mesit të natës për të shqyrtuar



rrjedhën e demonstratës së ditës; për të ngrënë dhe për të bërë gjumë, ndërsa mikpritësi me

zemër të madhe, Dina, si gjithnjë, krahas pjesëmarrjes së vazhdueshme gjatë ditës në demon-

strata, përveç mirëseardhjes së dëshiruar nga zemra në çdo kohë, s'do të harronte asnjëherë, kur brenda ndodheshin ish të burgosur politikë, për të dalë përjashta dhe për të bërë roje. Për të bërë roje e organizuar roje. Krejt në heshtje. Me xhelozin do ta ruaj përjetësisht kujtimin dhe respektin për patriotin e përkushtuar Dinë Grabovci. Qoftë i përjetshëm kujtimi dhe nderimi i kombit tonë për sakrificën dhe gjakun e derdhur nga kushërinjtë dhe bashkëfshatarët e mi për çlirimin dhe pavarësimin e Kosovës!

Elezaj inspekton punimet në asfaltimin e rrugëve në qytet të Klinës

KLINË, 8 MAJ (ER) - Në Klinë ka filluar asfaltimi i rrugëve kryesore të qytetit nga rruga "Leonard Palucaj" deri te Sheshi "Nëna Terezë", duke vazhduar me rrugët

"Muhamet Haxhaj", "Hamit Krasniqi" dhe rruga "Hasan Prishtina". Për t'i inspektuar punimet të mërkurën ka dalë kryetari i komunës, Zenun Elezaj, i cili ka theksuar se

këto punime mjaft të rëndësishme po kryhen në mënyrë që ta shmangin komunikacionin e ngarkuar dhe krijimin e një qarkullimi sa më të lehtë brenda qendrës së

qytetit. Ai, po ashtu, nga operatori ekonomik ka kërkuar që punët të kryhen në mënyrë cilësore dhe sipas parametrave të paraparë në kontratë.



Pompeo viziton Londrën pas Bagdatit, diskuton për Iranin

LONDËR, 8 MAJ - Sekretari amerikan i Shtetit, Mike Pompeo, vizitoi Londrën të mërkurën pas deklaratave të Iranit se nuk do t'u përmbahej më disa pjesëve të marrëveshjes bërthamore nga e cila Shtetet e Bashkuara u tërhoqën pikërisht një vit më parë. Marrëveshja kufizon aftësinë e Iranit për prodhimin e lëndës djegëse bërthamore për 15 vjet. Pompeo diskutoi mbi Iranin me kryeministren britanike Theresa

May dhe me sekretarin e Jashtëm Jeremy Hunt. Në agjendë ishte edhe propozimi për një marrëdhënie të veçantë mes dy aleatëve pasi Britania të jetë tërhequr nga Bashkimi Evropian. Pompeo shkoi në Londër, pas anulimit të një udhëtimi në Gjermani për të bërë një vizitë të panjoftuar në Bagdad, ku ai paralajmëroi zyrtarët irakianë të mos ndërmarin sulme kundër intereseve amerikane në Lindjen e

Mesme. Vizita vjen në klimën e tensioneve në rritje me Iranin pas njoftimeve të zbulimit se Teherani ka dislokuar me anije raketa balistike me reze të shkurtër veprimi në ujërat pranë brigjeve të tij. "ShBA-ja do t'i mbrojë interesat e veta kudo që të jenë dhe ne gjithmonë do të sigurohemi që të kemi një strukturë force që besojmë se mund ta arrijë këtë qëllim. Pra, vizita ime dhe veprimet e ndërmarra nga Departamenti i Mbrojtjes,



mesazhi që u kemi dërguar iranianëve, shpresoj se na e bën të mundur t'i dalim përpara kësaj

dhe iranianët do të mendohen dy herë para se t'i sulmojnë interesat amerikane", tha Pompeo.

Irani heq dorë pjesërisht nga marrëveshja bërthamore

Presidenti iranian Hassan Rohani ka thënë se nënshkruet e tjera të marrëveshjes, Britania, Franca, Gjermania, Kina dhe Rusia, kanë 60 ditë për të marrë masa për mbrojtjen e sektorit të naftës irانية dhe atë bankar

TEHERAN, 8 MAJ - Presidenti iranian Hassan Rohani ka thënë se Republika Islamike do ta rifillojë pasurimin e uranimit nëse fuqitë botërore nuk mbrojnë interesat e këtij shteti kundër sanksioneve të Shteteve të Bashkuara.

Adresimi televiziv i Rohanit është transmetuar të mërkurën nga televizioni shtetëror, teksa është shënuar njëvjetori i largimit të ShBA-së nga marrëveshja bërthamore, që Teherani ka nënshkruar me fuqitë botërore më 2015.

Rohani ka thënë se nënshkruet e tjera të marrëveshjes, Britania, Franca, Gjermania, Kina dhe Rusia, kanë 60 ditë për të marrë masa për mbrojtjen e sektorit të naftës irانية dhe atë bankar.

Rohani u ka nisur shkresa liderëve të pesë shteteve, duke thënë se Irani do të fillojë të mos përm-bushë në tërësi marrëveshjen e vitit 2015 dhe nuk do të eksportojë uranin të pasuruar dhe as ujë të rëndë te kombet e tjera, ashtu siç është e përcaktuar në marrëveshje.

Mediet shtetërore irانية kanë raportuar se letrat u janë dërguar ambasadorëve të pesë kombeve që janë pjesë e marrëveshjes bërthamore. "Nëse pesë shtetet u bashkohen negociatave dhe i ndihmojnë Iranit që të përfitojë nga fusha e naftës dhe ajo bankare, Irani do ta zbatojë në tërësi marrëveshjen", ka thënë Rohani.

Megjithatë, Rohani ka paralaj-



jmëruar për një "reagim të ashpër" nëse liderët evropianë vendosin më shumë sanksione ndaj Iranit përmes Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara.

Ministri i Jashtëm iranian, Mohammad Javad Zarif po ashtu ka thënë se "pas një viti të durimit, Irani u ka dhënë fund masave, të cilat i ka bërë të pamundshme SHBA-ja, për t'i vazhduar".

Pak pas fjalimit të Rohanit, ministri francez i Mbrojtjes, Florence Parly ka thënë se Franca dëshiron të mbajë gjallë marrëveshjen

bërthamore dhe ka paralajmëruar se nëse Irani nuk zbaton në tërësi marrëveshjen atëherë mund të vendoset një mekanizëm që nuk përjashton sanksionet.

Parly ka thënë se asgjë nuk do të ishte më e keqe sesa largimi i Iranit nga marrëveshja bërthamore.

Marrëveshja e vitit 2015 i ka siguruar Iranit lirim nga sanksionet ndërkombëtare në këmbim të frenimit të aktivitetit bërthamor. Mirëpo presidenti amerikan, Donald Trump, ka njoftuar në maj

të vitit të kaluar se do ta largojë ShBA-në nga kjo marrëveshje, duke e cilësuar atë të mangët, meqë sipas tij nuk përfshin zhvillimin e raketave balistike të Teheranit dhe mbështetjen për disa rrjete në Lindje të Mesme.

Uashingtoni po ashtu ka kthyer të gjitha sanksionet ndaj këtij shteti, duke i dëmtuar rëndë ekonominë. Agjencia Ndërkombëtare për Energji Atomike, ka thënë se pavarësisht hapave amerikanë, Teherani ka vazhduar të zbatojë marrëveshjen.

Kjo agjenci funksionon në kuadër të OKB-së për t'i monitoruar aktivitetet bërthamore të Iranit.

Mbështetësit evropianë të marrëveshjes kanë tentuar të ruajnë këtë dokument, mirëpo Teherani është ankuar se procesi ka qenë shumë i ngadalshëm.

Tensionet në mes të Teheranit dhe Uashingtonit janë rritur prej kur SHBA-ja është tërhequr nga ky dokument, dhe prej kur kjo e fundit ka rritur presionin ndaj Iranit.

Ushtarët turq drejt Rosisë për trajnimin anti-raketor



ANKARA, 8 MAJ - Personeli ushtarak turk, i ngarkuar me operimin e sistemeve të mbrojtjes raketore S-400 do të arrijë në Rusi në fund të majit. Lajmi është bërë i ditur për mediet turke nga një burim ushtarak rus. "Në fund të majit, rreth 100 ushtarakë turq do të fillojnë trajnimin në një qendër ushtarake ruse për të operuar sistemet e mbrojtjes raketore S-

400", citon burimi anonim i "TASS".

Sistemet S-400 do të dorëzohen në Turqi nga eksportuesi i pajisjeve ushtarake të Rosisë, "Rosoboronexport" deri në fund të vitit, ashtu siç është planifikuar.

Personeli ushtarak turk, së bashku me personelin nga Kina do të trajnohen në një qendër ushtarake. "Trajnimi anti-rake-

tor nga Kina dhe Turqia do të përfaqësojë një rast të pashembullt në historinë e (ish-Bashkimit Sovjetik) dhe Rosisë moderne", tha burimi për TASS.

Nga ana tjetër, ShBA-ja ka paralajmëruar presidentin Rexhep Taip Erdogan që të mos blejë raketa nga Rusia, pasi në të kundërt do të ketë sanksione të ashpra ndaj Turqisë.

Rusia dëbon dy diplomatë suedezë

STOKHOLM, 8 MAJ - Rusia dëboi dy diplomatë suedezë pasi shteti skandinav refuzoi dhënien e vizave për dy diplomatë rusë, deklaroi të mërkurën Ministria suedeze e Punëve të Jashtme, një vendim që rrezikon të për-

shkallëzojë marrëdhëniet tashmë të tendosura mes dy shteteve. "Rusia është kundërpërgjigjur duke u kërkuar dy diplomatëve suedezë të largohen nga Rusia", njoftoi një zëdhënëse e Ministrisë, e kontaktu-

ar nga media, por pa dhënë më shumë detaje.

Ministria ruse e Punëve të Jashtme nuk ka dashur ta komentojë informacionin. Vendimi i Moskës vjen pak më shumë se dy muaj pas arrestim-

it në fund të shkurtit në Stokholm të një personi, e cila punonte në teknologjitë e avancuara, e dyshuar për spiunazh në Suedi në favor të Rosisë, pas rekrutimit të saj nga një agjent i shërbimeve sekrete ruse që



vepronte nën mbulimin diplomatik.



BeyAb for bread

Risi, tani BEYAB-in mund ta gjeni edhe nëpër dyqanet e Kosovës. BeyAb është prodhim turk, dhe përpos tregut në Shqipëri e Mal të Zi tani edhe në Kosovë.



E jashtëzakonshme

Qyteti ku shtëpitë shiten për një euro

Mussomeli është një qytet në Sicilinë jugore ku po shiten qindra shtëpi antike për një euro në internet. Qeveria lokale mori vendimin për shitjen e shtëpive me çmimin e ulët në një përpjekje për ta ringjallur zonën. Shumë prej fshatrave të vegjël të Italisë po përjetojnë një eksod masiv pasi banorët largohen drejt zonave urbane.



FOTO E DITES




Një bujk shihet duke ndarë trëndafila për të bërë vajra esenciale në një plantacion në Kinë. Fotografia është publikuar te "Zëri i Amerikës".

E rrallë

Gjendet kokaina 1 000-vjeçare

Një zbulim në Amerikën e Jugut ka bërë krejtësisht të qartë se njerëzit që jetuan në kontinentin tonë 1 000 vjet më parë kishin disa të përbashkëta me njerëzit e sotëm. Dhe shkencëtarët kanë gjetur një të ashtuquajtur pako të lashtë që mbante brenda kokainë. Koleksioni 1000-vjeçar i veglave të drogës u gjet në një strehë guri në Bolivi dhe brenda përmbante pesë kimikate psikoaktive, përfshirë kokainën. Pajisjet u gjetën në vendin arkeologjik të Cueva del Chileno, një shpellë në Bolivinë jugperëndimore.



BARSOLETA E DITËS



- Kamerier, a mund të vish pak këtu?
- Po zotëri, menjëherë!
- Provoje pak supën.
- Me çka, se? S'paska lug.
- Me pas lug s'të kisha thirr.



Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Në ora 16:00

"HOW TO TRAIN YOUR DRAGON; The Hidden World" 3D

I Animuar/Aksion Aventure; 1 ore 44 min

Rolet: Jay Baruchel, America Ferrera, Cate Blanchett, Kit Harrington, Craig Ferguson, F. Murray Abraham, etj.
Regjia: Dean DeBlois



Në ora 18:00 (gjate vikendit ne ora 14:00 dhe 18:00)

"THE KID WHO WOULD BE KING"

Aventurë/Familjar/Fantazi; 1 ore 50 min

Rolet: Louis Ashbourne Serkis, Dean Chaumoo, Tom Taylor, Rhianna Dorris, Angus Imrie, Rebecca Ferguson, Patrick Stewart, etj.

Regjia: Joe Cornish



Në ora 20:00

"CAPTAIN MARVEL" 3D

Aksion/Aventurë/Sci-Fi; 2 ore 08 min

Rolet: Brie Larson, Samuel L. Jackson, Ben Mendelsohn, Djimon Hounsou, Lee Pace, Gemma Chan, Annette Bening, Jude Law, etj.

Regjia: Anna Boden, Ryan Fleck




Në ora 22:00

"U S"

Horror/Triller; 1 ore 56 min

Rolet: Lupita Nyong'o, Winston Duke, Elisabeth Moss, Tim Heidecker, Yahya Abdul-Mateen II, Anna Diop, Evan Alex, Shahadi Wright Joseph, Madison Curry, Cali Sheldon, Noelle Sheldon

Regjia: Academy Award@-winning visionary Jordan Peele



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni **FALAS: 0800 22 222** dhe **boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.**



DASHI

Keni marrë përsipër shumë aktivitete


njëherësh. Nuk do ta përfundoni asnjërin prej tyre sepse ngarkesa do të jetë e madhe.



DEMI

Një situatë e komplikuar mes kolegësh sot

do të marrë një drejtim tjetër. Nëse rrezikoni bashkëpunimin në fund do t'ju fajësojnë juve.



BINJAKËT

Sot duhet të thoni një fjalë të mirë për një

person që ju e njihni mjaft mirë dhe që sot do ta kërkojë ndihmën tuaj.



GAFORRJA

Nuk do të mund të realizoni sot objektivat

tuaja nëse nuk e ndani që në mëngjes programin e ditës. Çdo e papritur penalizon finalizimin e punës.



LUANI

Një gënjeshtër që ju kanë

thënë do të vazhdojë të thellohet më shumë. Kujdes me personat që mbani pranë vetës.



VIRGJËRËSHA

Raportet personale nuk duhet të ndikojnë

në ato profesionale sepse do ta prishni punën tuaj. Një çështje delikate ka zënë ditën tuaj sot.



PESHORJA

Surpriza për ditën e sotme do të jetë takimi

me një mik të vjetër. Do të shikoni që koha ka ndaluar dhe këshillat e tij janë gjithmonë të vlefshme.



AKREPI

Keni limitet tuaja në fusha të caktuara dhe

do të jetë mirë ta pranoni këtë gjë. Nuk ka asnjë problem nëse kërkon ndihmë.



SHIGJETARI

I keni zgjedhur mjaft mirë kundërshtarët

tuaj dhe do të arrini t'i manipuloni deri në momentin që e quan të arsyeshme.



BRICJAPI

Po keqkuptoni afrimin e dikujt

sot, dhe do t'ju duket sikur ka ide të tjera nga ato që ju ka shprehur. Do të kuptoni me kohë se keni gabuar.



UJORI

Herë pas here ju kap ndërgjegjja

për veprimet që keni bërë në të kaluarën. Keni kohë për t'i rregulluar situatat nëse i viheni punës.



PESHQIT

Dita do të ketë mjaft lëvizshmëri sa në

një çast të caktuar do t'i harroni prioritetet tuaja. Një familjar do të mërzhitet nga kjo neglizhencë.

Naomi Watts nuk u ftua në Met Gala 2019



Naomi Watts përmes një postimi në "Instagram" ka bërë me dije se nuk ishte e ftuar në Met Gala. Procesi i krijimit të listës së mysafirëve, krijuar çdo vit nga Anna


Wintour, është jashtëzakonisht i fshehtë dhe nuk është lëshuar zyrtarisht. Naomi mori pjesë në Met Gala në vitin 2008, 2010, 2011, 2014, 2016, 2017 dhe 2018.

Për herë të parë Katie dhe Jamie pozojnë publikisht pranë njëri-tjetrit



Nuk ka vend më të mirë për ta bërë lidhjen zyrtare sesa Met Gala. Çifti i njohur Katie Holmes dhe Jamie Foxx befasuan fansat duke u paraqitur bashkë në ngjarjen më të madhe të modës. Të dy

shkëlqyen në veshjet që kishin zgjedhur për këtë ceremoni. Katie dhe Jamie, të cilët kanë qenë të lidhur që nga viti 2013, e kanë mbajtur shumë private marrëdhënien e tyre, madje shpesh edhe e kanë mohuar.



Dua Lipa debuton në Met Gala, kthen kokat e të gjithëve

Dua Lipa ka debutuar në Met Gala. Kjo është hera e parë që këngëtarja 23-vjeçare e hitit "New Rules" është paraqitur në tapetin e kuq në këtë ngjarje që mbahet në Nju Jork. Këngëtarja e

famshme me prejardhje shqiptare shoqërohej nga i dashuri Isaac Crew. Lipa kishte veshur një fustan të markës së njohur "Versace" që e kishte kombinuar me një çizme të Mei Kawajiri.

Brad Pitti mohon të jetë rikthyer me Jennifer Anistonin



Disa muaj më parë Brad Pitt ishte i pranishëm në ditëlindjen e 50 të ish të dashurës Jennifer Aniston dhe thashethemet filluan rreth një marrëdhënie të çiftit gjatë asaj kohe. Por, një paparac vendosi t'i kërkonte një përgjigje aktorit

rreth 'lidhjes'. "Më duhet t'ju pyes sepse të gjithë duan ta dinë, a po ktheheni së bashku?", e pyeti ai Bradin. "Oh Zoti im!", ishte përgjigja e aktorit. Bradi dhe Jenniferi u martuan në vitin 2000, por u ndanë në vitin 2005.

Dalin super-kartëmonedhat e reja 100 dhe 200 euro! S'pyesin për lavatriçe e hekurosje

Duke nisur nga fundi i këtij muaji do të dalin në qarkullim kartëmonedhat e reja 100 dhe 200 euro. Ndryshe nga kartëmonedhat që janë në qarkullim, ato kanë elemente të tjera vizive dhe elemente sigurie. Karakteristikë e këtyre kartëmonedhave është rezistenca e tyre në përdorim. Banka Qendrore Europiane ka publikuar edhe një video që tregon karakteristikat e kartëmonedhave, duke bërë edhe eksperimentet përkatëse. Në video kartëmonedhat i rezistojnë hekurosjes me hekur të nxehtë, larjes në lavatriçe, agjentëve kimikë agresivë, ngricës, qëndrimin të gjatë në diell, nxehtësisë ekstreme etj. Parashikimet janë që karakteris-

tikat e reja të kartëmonedhave t'ua vështirësojnë tej mase "punën" falsifikatorëve. Biletat 100 dhe 200 euro të prezantuara te Banka Qendrore Europiane kompletojnë serinë "Europa" të nisur me hedhjen e kartëmonedhave 5 euro nga maji i 2013. Veç rritjes së rezistencës së kartëmonedhës në përdorim, në kartëmonedhat e reja ndryshon edhe ngjyra e tyre duke kaluar nga jeshilja e smeraldë në blu të errët, duke prodhuar efektin e një dritë që spostohet në drejtimin vertikal. Po ashtu, në kartëmonedha simboli i euros shfaqet disa herë në brendësi të shifrës. Në të djathtën e kartëmonedhës mund të vërehet një hologram me katër elemente.



DJ i famshëm vdes ndërsa ndihmonte mikeshën që ra nga ballkoni

Një vdekje tragjike për Adam Sky, ose i njohur ndryshe si Adam Neat, një nga DJ-të më të famshëm në Lindje. Gjatë një feste, një mikeshë e zhveshur ra nga ballkoni i pishinës private në vendpushimin luksoz të Hillstone Vilas në Bali, Indonezi. Neat u përpoq ta shpëtojë, por u përplas ndaj nje dere xhami. Këto të fundit i kanë prerë një arterie dhe ai vdiq mes një pellgu gjaku. Sipas hetuesve, të dy ishin të dehur. Njoftimi erdhi direkt në profilin e "Facebook" të DJ, i cili ka mbi 900,000 pëlqime. "Me dhimbje të madhe, konfirmojmë se Adam Neat është përfshirë në një aksident fatal, ndërsa përpiqej të ndihmonte një mikeshë, duke pësuar frakturë të shumta në Bali". Dhoma e tij kishte një terracë tavoline me një pishinë private dhe natën e së premtes (natën e së shtunës me orën evropiane,) ai organizoi një festë me miqtë.

Në një moment, Zoia Lukiantcev, një mikeshë e artistit, ra nga ballkoni i pishinës, ndërsa ajo ishte lakuriq, duke përfunduar në një shkurre disa metra më poshtë. Ndikimi me vegetacionin i shpëtoi jetën e saj, por nuk i kurseu disa fraktura në këmbë. Duke dëgjuar thirrjet për ndihmë, Neat u përpoq ta arrinte atë duke vrapuar, por përplasia me një derë xhami ishte fatale, me copat që çanë arterien e krahut të tij, duke e lënë atë në një pellg gjaku. Stafit i hotelit i gjeti të dy vetëm të nesërmen dhe menjëherë lajmëruan policinë. Zoia Lukiantcev ishte e pavetëdijshme në kohën kur u gjet dhe tani është shtruar në spital pa rrezik për jetën. Neat ishte banor i Singaporit dhe ishte ndër tre DJ-të më të famshëm në Azi. Ai ka punuar gjithashtu me personalitete të tilla si David Guetta, Scissor Sisters, e Fatboy Slim.



Vriste komshijet e shtëpisë, njihuni me “Tmerrin e Hollivudit”



Në mesin e dëshmitarëve të thirrur për të dëshmuar kundër tij do të jetë gjithashtu edhe Ashton Kutcher. Ish-bashkëshorti i Demi Moore kishte për të shkuar me të dashurën e tij të kohës, Ashley Ellerin, në një festë post çmimeve “Grammy” më 21 shkurt. Ai e gjeti atë të vdekur në shtëpi, të vvarë me 47 plagë të shkaktuara nga një thikë. Njeriu i akuzuar për atë krim dhe të paktën dy të tjerë, quhet Michael Gargiulo dhe gjykimi që e sheh si të pandehur filloi në këto ditë në Los

Anxhelos.

Gargiulo, tani 43 vjeç, është cilësuar si “Tmerrin e Hollivudit”. Fillimisht nga Illinois, krimi i tij i parë daton kur ai ishte 17 vjeç: viktimitë mbeti fqinja e shtëpisë së tij, tetëmbëdhjetë vjeçarja, Tricia Pacaccio. U godit 47 herë me grushte dhe mjete të tjeëra të forta, ajo u gjet e vdekur nga babai i saj. Një vrasje që ka mbetur e pazgjidhur për shumë vite. Dhe sipas prokurorisë, thuhet se ishte kryer nga Gargiulo, “vrasësi i shtëpisë ngjitur”, i cili, pasi u shpërngul në Kaliforni, vrau dy gra të tjera.

Krimi i dytë daton që nga 21 shkurti 2001, kur Ashley Ellerin, në atë kohë e dashura e Ashton Kutcher, u godit me thikë 47 herë në shtëpinë e saj në Hollivud. Ashley u godit në stomak, në gjoks në shpinë, plaga në qafën e saj “ia kishte prerë pothuajse kokën”, kishin shpjeguar detektivët që kishin trajtuar rastin atë kohë. Atë mbrëmje, Ashley duhej të shkonte në një festë pas dhënies së çmimeve “Grammy” së bashku Ashton. Dhe ai, i cili do të dëshmojë në gjyq, e gjeti trupin e saj të pajetë.

Duke mbërritur para shtëpisë, aktori kishte parë njollat ??në tokë “dukej si verë”. Ishte gjak, gjaku i Ashley.

Në vitin 2005, Maria Bruno, një fqinje e Michael Gargiulo, u vra në shtëpinë e saj në El Monte të Kalifornisë, me 17 plagë në trup. Krimet mbeten pa fajtor, deri në vitin 2008, kur në Santa Monica, Gargiulo përpiqet të vrasë fqinjes e saj, Michelle Murphy. Ai e sulmon atë me thikë, ndërsa ajo ndodhej në shtrat, duke e goditur.

Por Michelle arrin të ikë: ajo është dëshmitarja e vetme oku-

lare, e vetmja e mbijetuar. Gjaku i gjetur në shtëpinë e saj korrespondon me atë të Gargiulo-s, dhe kjo është mënyra se si ADN-ja krahasohet me gjurmët e gjetura në skenat e krimeve të tjera.

Hetuesit dyshojnë se viktimat e Gargiulos mund të jenë një duzinë, por tani për tani, njeriu i arrestuar në Los Anxhelos duhet t'i përgjigjet vetëm vrasjeve të Ashley Ellerin dhe Maria Bruno dhe tentativës së vrasjes së Michelle Murphy. Edhe pse rrezikon dënimin me vdekje, ai gjithmonë nuk i ka mohuar akuzat për vrasje.

EUROGLASS
SAINT-GOBAIN
SEKURIT PILKINGTON
Enveri

Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"

TEL: 045 82 82 82

Rexha, porosi ish-skuadrës: Pikët mbesin në Drenas

Kastriot Rexha ka paralajmëruar të mërkurën për "Epokën e re" se Feronikeli do të shënojë fitore në fundjavë në derbin ndaj Dritës. "Ne jemi të përanditur maksimalisht dhe objektivi i vetëm në këtë ndeshje është fitorja. Duhet të vazhdojmë me lojërë të mira edhe në këto ndeshjet e mbetura dhe ta arrijmë synimin e klubit", ka thënë Rexha

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 8 MAJ - Sulmuesi Kastriot Rexha i ka dërguar të mërkurën porosi ish-skuadrës së vet, Dritës nga Gjilani, se nga Drenasi do të rikthehet duarthatë. Feronikeli dhe Drita të shtunën nga ora 16:00 takohen në stadiumin "Rexhep Rexhepi" në derbin e dytë të javës së 31-të në IPKO Superligën e Kosovës në futboll.

Sulmuesi shtatartë për "Epokën e re" ka thënë se Drita, edhe përkundër asaj që është jashtë garës për titull, po e nderon kampionatin dhe se një gjë e tillë është e mirë për futbollin e Kosovës. "Ndeshja me Dritën do të jetë e rëndësishme për ne, pasi jemi në garë të ngushtë me Prishtinën dhe Llapin për titull. Dihet se Drita nuk ka presion dhe ka skuadrë të mirë, çka dëshmoi edhe në ndeshjen e kaluar kur e ndali Prishtinën, duke e nderuar kampionatin dhe e njëjta mund t'i ndodhë edhe Feronikelit, por

kjo është në të mirë të futbollit të Kosovës. Ne jemi të përgatitur maksimalisht dhe objektivi i vetëm në këtë ndeshje është fitorja. Duhet të vazhdojmë me lojërë të mira edhe në këto ndeshjet e mbetura dhe ta arrijmë qëllimin e klubit", ka thënë Rexha, i cili nuk ka dashur të tregojë se a do të festojë në rast se shënon ndaj Dritës. "Do të jetë lojë interesante për publikun dhe e veçantë për mua si futbollist, pasi në kampionatin e kaluar kemi arritur të shpallemi kampionë. Kam respekt për këtë skuadrë, pasi kemi kaluar kohë të mira së bashku", ka shtuar ai.

Ish-sulmuesi i shumë skuadrave në Kosovë ka qenë shumë herë i dyti dhe i treti në listën e golashënuesve më të mirë, por asnjëherë nuk ka qenë i pari. Këtë çmim Rexha është afër ta fitojë në këtë kampionat, pasi ka tetë gola më shumë se përcjellësi i parë. "Jam aktualisht i pari në listën e golashënuesve dhe afër të shpalle më i miri, por ende nuk ka përfunduar asgjë dhe se në

futboll gjithçka është e mundur. Shpeshherë në të kaluarën kam dal i dyti dhe i treti, kurse tash jam afër të dal i pari dhe normalisht, si çdo futbollist tjetër që dëshiron të ketë çmime të fituar, e dua edhe unë, gjithmonë duke pasur primar rezultatet e skuadrës", ka deklaruar Rexha. Kontrata e futbollistit Rexha me skuadrën e "Niklit" është deri në fund të kampionatit, sikurse që ishte edhe vitin e kaluar me Dritën. I pyetur se a rrezikon të mos paraqitet në garat evropiane sikurse në edicionin e kaluar, gjithmonë nëse shpallet kampion ose fitues i Kupës me Feronikelin, Rexha është përgjigjur: "Ne bëjmë një rrugëtim të suksesshëm me Dritën, por më pas nuk gjetëm gjuhë të përbashkët për ta vazhduar bashkëpunimin. Kjo bëri që të mos luaj në garat ndërkombëtare. Fillimisht jam i përçudruar që ta arrijmë objektivin me klubin e më pas do të bisedojmë për të ardhmen. Shpresoj që këtë vit të luaj në Evropë".



Më 22 maj zhvillohet finalja Kosova (P) - Mitrovica

Ndeshja finale e Kupës së Kosovës në konkurrencën e femrave ndërmjet Kosovës (P) dhe Mitrovicës do të zhvillohet më 22 maj. Edhe kjo ndeshje finale do të zhvillohet në stadiumin "Fadil Vokrri" në Prishtinë, kurse fillon në orën 19:00. Në gjysmëfinale Kosova (P) e eliminoi Lirinë pas dy ndeshjeve me rezultat të përgjithshëm 4-2, kurse Mitrovica e eliminoi Feronikelin pas dy ndeshjeve, me rezultat të përgjithshëm 3-1.

Gjashtë ndeshje moslojë për Lecin, dy për Rusin



PRISHTINË, 8 MAJ - Komisioni Disiplinor i shkallës së parë i Federatës së Futbollit të Kosovës e ka dënuar me gjashtë ndeshje moslojë futbollistin e Dritës, Liridon Lecin. Dënimi për Lecin ka ardhur pasi ai në përfundim të ndeshjes ndaj Trepçës '89 e ka ofenduar asistentin Granit Hyseni dhe ka sulmuar lojtarin e '89-shit, Hasan Hyseni. Me dy ndeshje moslojë është dënuar edhe lojtari i Trepçës '89, Gëzim Rusi, i cili e goditi lojtarin

kundërshtar në ndeshjen Llapi - Trepça '89. Komisioni Disiplinor e ka dënuar edhe skuadrën e Llapit me 1 000 euro për shkak të shpalesjes së një pankarte me përmbajtje josportive në ndeshjen ndaj Dritës si dhe ndezjen e flakadanëve dhe hedhjen e njërit prej tyre në pjesëfushën e ekipit mysafir dhe ofendimet e orkestruara nga publiku nikoqir drejtuar lojtarëve mysafirë. Zyrtari i Llapit, Muhamet Rexhepi, është dënuar me 500

euro pas përjashtimit nga bankina, kurse trajnerit të portierëve, Bekim Mulliqit, i është tërhequr vërejtja e fundit. Më shumë 1 000 euro është dënuar edhe skuadra e Ballkanit, e cila këtë vendim e mori pasi dy persona para fillimit të ndeshjes Ballkani - Ferizaj e fyen, ofenduan dhe kërcënuan gjyqtarin kryesor Mervan Bejtullahu. Ndërsa drejtori sportiv i kësaj skuadre, Ismail Kosumi, është dënuar me masën disiplinore të qortimit.

Sonte mësohen finalistët në Ligën e Evropës

LONDËR, 8 MAJ - Sonte (e enjte) zhvillohen dy ndeshjet kthyesë në gjysmëfinale të Ligës së Evropës dhe me këtë rast do të mësohen dy finalistët e këtij edicioni në garën e dytë më të fortë në futboll. Arsenali i Granit Xhakës dhe Shkodran Mustafit ka bërë një hap të madh drejt finales së madhe, pasi në ndeshjen e parë ka shënuar fitore ndaj Valencias (3-1). Arsenali ka bërë

një hap pas në fundjavë për t'i mbajtur shpresat për një vend që e dërgon në Ligën e Kampionëve, pasi luajtur baras ndaj Brightonit (1-1) dhe tash duhet ta kërkojë trofeun e Ligës së Evropës, pasi ai ia siguron në sezonin tjetër pjesëmarrjen në Ligën e Kampionëve. Nëse triumfon Arsenali në këtë garë, për trajnerin Unai Emery do të ishte trofeu i katërt, për faktin se tri

herë e ka fituar me Sevillan. Një vend tjetër në finale mund ta sigurojë edhe skuadra e Chelseat, e cila në ndeshjen e parë ndaj Eintracht Frankfurtit mori barazim (1-1) dhe tash do ta ketë përparësinë e terrenit vendës.

Të enjten takohen:
Valencia - Arsenal (1-3)
Chelsea - Eintracht Frankfurt (1-1)



MKRS-ja përkrah Federatën e Sporteve për të Verbër dhe licencën Federatën Muaythai të Kosovës

PRISHTINË, 8 MAJ - Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi, ka nënshkruar memorandum bashkëpunimi me Federatën e Sporteve për të Verbër të Kosovës dhe, po ashtu, ka nënshkruar licencimin e Federatës së Muaythai të Kosovës. Qëllimi i memorandumit të nënshkruar

është mbështetja financiare me 30 mijë euro për periudhën janar-dhjetor 2019. Ministri Gashi ka thënë se përkrahja financiare për Federatën e Sporteve për të Verbër është në vazhden e nënshkrimit të memorandumëve për përkrahjen e federatave sportive të Kosovës.

Ndërkaq për licencimin e Federatës së Muaythai të Kosovës, ministri Gashi u shpreh: "Licencimi i kësaj federate tregon përkushtimin tonë për krijimin e kushteve për sportin në vend e në këtë rast edhe për sportin muaythai. Me qëllim të përmirësimit të kushteve të rin-

jve, ne do të vazhdojmë ta përkrahim krijimin e federatave të reja sportive për sportet të cilat në vendin tonë nuk janë shumë të zhvilluara. Ne besojmë se ky licencim është një motiv shtesë për të punuar në zhvillimin e këtij sporti për talentet e reja të Kosovës".



Shaqiri: Jam i shokuar dhe jashtëzakonisht krenar



flasësh tani, pasi jemi ende të shokuar nga ajo çfarë ndodhi", ka thënë Shaqiri. "Është unike dhe diçka që nuk ndodh çdo ditë. Nuk ka qenë e lehtë për mua këta tre muajt e fundit. Nuk kam luajtur shumë, por gjithmonë kam pritur për momentin tim dhe jam stërvitur fort. Është një ndër klubet më të mëdhenj dhe duhet ta bësh diferencën", ka deklaruar Shaqiri.

Kloppi: Nuk mbaj mend ndeshje si kjo

Trajneri i Liverpoolit, Jurgen Klopp, ka deklaruar se asnjëherë në jetën e tij nuk ka përjetuar një ndeshje të tillë. Ekipi i tij arriti ta përmbyste rezultatin prej 3-0 nga ndeshja e parë, duke fituar në 'Anfield Road' me rezultat prej 4-0, që çon në finale të Ligës së Kampionëve. "E tërë performanca, në fakt e tërë ndeshja ishte shumë e madhe. Para ndeshjes u thashë lojtarëve se ishte e pamundur, por ishin ata dhe kishin një shans. Kam shikuar kaq shumë ndeshje në jetën time, por s'mbaj mend një ndeshje të tillë", ka deklaruar Klopp.

LIVERPOOL, 8 MAJ - Liverpooli bëri një ndër përmbysjet më të pabesueshme ndaj Barcelonës, pasi e mposhti me rezultat 4-0, duke e bërë të pavlefshme fitoren e fazës së parë 3-0 të katalanasve. Një ndër protagonistët absolutë ishte edhe Xherdan Shaqiri, i cili foli pas sfidës, mjaft i emocionuar. Djaloshi nga Gjilani ka thënë se diçka e tillë nuk i kishte ndodhur kurrë dhe se ndihej jashtëzakonisht krenar për ekipin e tij dhe për arritjen e bërë. "Është e vështirë t'i gjejsh fjalët pas një ndeshje të tillë. Jam pafundësisht krenar për

ekipin dhe për atë çfarë arritëm të bënim. Nuk patëm një javë të lehtë, pasi patëm edhe dëmtimet, por ne donim ta luanim ndeshjen tonë. Jam i shokuar dhe jashtëzakonisht krenar. E vetmja gjë që mund të them është se kurrë nuk kam përjetuar diçka të tillë më parë. Mendoj se në jetë gjithmonë duhet të besosh. Kjo vlen kudo, në futboll dhe në jetë. Besimi duhet të jetë gjithmonë edhe nëse të gjithë mendojnë se nuk do të arrihet. Besimi ishte te ne dhe bëmë gjithçka që mundëm, më pas ndodhi ajo që ndodhi. Është e vështirë të

Toronto dhe Denveri, afër finaleve të 'play-off'-it

TORONTO, 8 MAJ - Toronto Raptorsi dhe Denver Nuggetsit kanë triumfuar, duke marrë kryesimin pas ndeshjeve të pesta të gjysmëfinaleve të konferencave. Kanadezët mposhtën Philadelphia 76ers 125-189, në një ndeshje ku diferenca u bë në periodën e dytë dhe të katërt. Pascal Siakam (25 pikë, 3 asistime, 8 rebounde) dhe Kawhi Leonard (21 pikë, 4 asistime, 13 rebounde) morën për dore Raptorsin, që është një fitore larg finaleve.

Kyle Lowry (19 pikë) dhe Danny Green (17 pikë) dhanë një ndihmë të madhe gjithashtu në arritjen e këtij triumfi. Jimmy Butler për 76ers arriti të shënojë 22 pikë, kurse Joel Embiid u ndal në kuotën e 13 të tillave. Tashmë u mbetet të tentojnë të reagojnë në ndeshjen e gjashtë. Denver Nuggets-Portland Trail Blazers



vazhdon të dhurojë emocione, por vendasit kanë dominuar totalisht. Plot 28 pikë diferencë pas tri periodave të para, rezultat që flet vetë. Nikola Jokiç u tregua sërish një përbindësh teksa shënoi 25 pikë, asistoi 6 herë dhe rikuperoi 19 topa në tabelë. Paul Millsap ishte gjithashtu në

lartësinë e duhur, duke realizuar 24 pikë, sikurse edhe Jamal Murray. Ky i fundit, veç 18 pikëve, regjistroi edhe 9 asistime e 5 topa të rikuperuar në tabelë. Damian Lillard për Blazersin shënoi 22 pikë dhe nuk pati mbështetjen e pjesës tjetër të skuadrës për t'i rezistuar Nuggetsit.

GJYSMËFINALET E KONFERENCAVE

Toronto Raptors-Philadelphia 76ers	125-89 (3-2)
Denver Nuggets-Portland Trail Blazers	124-98 (3-2)

SHKURT

Shabani: Kupa na motivon për titull

Te Kastrioti i Ferizajt janë edhe më të motivuar për fazën përfundimtare të kampionatit pasi e kanë fituar të dielën Kupën e Republikës së Kosovës. Anëtarë i U21 të Kosovës, Lulzim Shabani, ishte më efikas në atë ndeshje finale me 7 gola të shënuar. Shabani ka thënë se sukcesi në Kupë ka rritur motivin për ta fituar edhe titullin e kampionit. "E kemi pritur një finale të fortë dhe rivalizuese kundër Prishtinës, pasi kemi qenë të ngarkuar fizikisht nga ndeshja gjysmëfinale me Besën. Secili prej lojtarëve i kemi kryer detyrat e dhëna nga trajneri dhe mund të them se e kemi merituar më shumë se Prishtina këtë Kupë. Sa i takon gjysmëfinale të 'play-off'-it, do ta kemi sërish Deniz Terziqin në radhët tona, që do të ndihmojë shumë të gjithë ekipin për të arritur në finale. Falënderoj tifozët, 'Ujqit', që kanë qenë me ne gjatë gjithë kohës dhe, po ashtu, të gjithë shikuesit për përkrahjen e vazhdueshme në ndeshjet e FINALA të Kupës", ka thënë Shabani.

Valverde: Jemi të shkatërruar



Trajneri i Barcelonës, Ernesto Valverde, është ndarë shumë i zhgënjyer me performancën e ekipit të tij në "Anfield Road", ku pësoi humbje prej 4-0 për t'u eliminuar nga gjysmëfinalja e Ligës së Kampionëve. "Për momentin jemi të shkatërruar. Kjo është e tmerrshme. Me të vërtetë na vjen shumë keq. Gjithçka që bëjmë është që t'i kënaqim tifozët dhe t'u sjellim kënaqësi atyre që të jenë krenarë me lojtarët. Por, ky është futbollit, gjëra të tilla mund të ndodhin. Kemi pasur humbje të dhimbshme në të kaluarën", ka thënë Valverde. "Është rezultat i tmerrshëm për fansat tonë dhe neve. Ishim të pafat, por meritat shkojnë për Liverpoolin", është shprehur Valverde.

Realit, 280 milionë euro për Mbappen

Sipas "France Football", Kylian Mbappe, është objektivi kryesor i Zinedine Zidane për ta rikthyer në Madrid epokën e "galaktikëve" dhe raportohet se drejtuesit e Realit kanë dorëzuar në tavolinën e PSG-së një ofertë prej 280 milionë eurosh. Por nuk mbaron me kaq pasi, sipas revistës franceze, Realit kërkon të marrë në "Bernabeu" edhe dy yje të Premierë Ligës, Eden Hazard dhe Paul Pogba. Nëse blerja realizohet, atëherë Mbappe do të bëhej lojtari më i shtrenjtë në botë. Ndërsa Hazard dhe Pogba mendohet të kushtojnë 115 dhe 140 milionë euro respektivisht. Për t'i financuar pjesërisht këto shpenzime marra-mendëse lojtarët që do të largohen janë Gareth Bale, James Rodriguez, Isco dhe Karim Benzema.

Nuk ndryshon dënimi për Chelsean

Pak muaj më parë FIFA dënoi Chelsea me dy sesione të afatit kalimtar (verë 2019 dhe janar 2020) që të mos bëjë asnjë blerje, ndërsa shitjet lejohen, për nënshkrimet e padeklaruara me lojtarë ndërkombëtarë tek ekipet e moshave. Klubi nga Londra ka apeluar këtë vendim në Komitetin e Ankesave në FIFA. Edhe ky organ ka bërë me dije se mbetet në fuqi vendimi i parë. Masa disiplinore për Chelsean nuk do të ndryshojë: Asnjë nënshkrim me lojtarë meshkuj të ekipeve zinxhirë deri tek U16, me përjashtim skuadrën e femrave dhe atë të futbollit të sallave. Vendimi i vetëm që ka theksuar ndryshe Komiteti i Ankesave është se Chelsea mund të firmosë me lojtarë nën 16 vjeç nga Britania e Madhe, që do të thotë talentet e rinj mund të afrohet te skuadrat e akademisë, për të afruar një lojtar në skuadrën e parë duhet të dalë ndonjë supertalent nën këtë moshë. Këtë vendim e ka pritur edhe vetë Chelsea, duke qenë se shpresa e vetme e saj është te Gjukata e Arbitrazhit në Lozanë (CAS). Nuk dihet si do të jetë vendimi nga ky institucion, por klubi londinez beson tek zvarritja e çështjes të paktën deri në shtator, në këtë mënyrë ata do të kenë mundësi t'i bëjnë blerjet e nevojshme në afatin kalimtar të verës dhe të jenë të përgatitur për të mos afruar lojtarë për dy sesionet e ardhshme të afateve kalimtare.

1		Autor: GAZMEND MORINA	SABOTAZHET	PËRHAPJE E VALEVE	MUZIKANTI KISERI (shq.)	TË FIKËT	NORA ISTREFI	ZANORE	EPOKA E RE	HEROI NË FOTO 2	SHKENCA QË STUDIOJ MORALIN	MINDERI I ULËT (krah.)	PËREMËR PRONOR	KRIPË E ACIDIT NITRIK		
		LUMË NË SHQIPËRI							TENISTJA BELGE JUSTINE GLOBAL ARBITRATION REVIEW							
		BAR PËR TË DALË JASHTË (shq.)						GATESA BASHKËT.								
		AKTORI HOLLIVUDIAN ... STILLER (shq.)							NDESHJET ANA RUSO							
		KRYEQYTETI I KANADASË								KËNGËTARI PORTORIKAN ... MARTIN ISMET JASHARI					ROSTOCK NJË LLOJ BUFI	
		VOZË E MADHE DRURI QË SHËRMBEN PËR TË MBAJTUR DJATHË (shq.)								NOTË MUZIKORE ZANORE				KAPËRDIJ KOD I TELEFONIT MOBIL		
		INTENSITET, METËR; INDIUM								VIJË QË SHPIE UJIN NË MULLI	A		IDHULL RAMADAN (perkdh.)			
EPOKA E RE	HEROI NË FOTO 1	ARKEOLOGU SHQIPTAR SKËNDER	GJUMI I THELLË (med.) ARKA PREJ HEKURI KU RUHEN PARA	BASHKËT. NIKEL, AZOT	2				ALBANOLOGIA ... DURHAM						PUSULLAT	
TRADITË, ADET (sh.pashq.)									ISH FUTBOLLISTI ÇEK ... KOLLER (BORUSSIA DORTMUND)				ZANORE KËNGËTARI AMERIKAN ... BROWN (shqip.)			
BANOR I VIETNAMIT TË VJETËR									SHKRONJA TË NJËJTA				KASTRIOT TUSHA VEPRIMTARI I SHQUAR BEQIRI			
PATRIOTI YNË PRISHTINA							NË ÇFARË MASE		ZANORE				JO I VJETËR JETËSHKRIM			
GRIMCOVA (bised.)				UGANDA, TANZANIA	SIENA MALLKOJ				LLOJ PJEPR I VERDHË							
AKTORI YNË NASER									BANORE E HERSHME E NJË KRAHINE							
I MBUSHUR TËRËSISHT; I							KUVENDI I KOSOVËS		HOUSING AGENCY JAMAICA					BASHKËT. MARC ANTHONY		
AJËR (ang.)				MITRUSH KUTELI PARIM I QARTË E I PËRCAKTUAR MIRË		AMERICAN PUBLIC MEDIA	TEDI ALVES	SHKENCA QË STUDIOJ MORALIN	TREVISO	BOTIMI	DIJETAR FETAR MYSLIMAN TANI					
BASHKËT.		TINKA KURTI NJË STINË			BRINJËT E NJË TREKËNDËSHI PËREMËR PRONOR							SHTET (huaj)				
DËMTIM I NJË MEKANIZMI GJATË LËVIZJES						PËRFUNDIM NË SHAH FILM I YNI "... ISHIN KATËR"					DRITËRO AGOLLI FUTBOLLISTI DANIELE (MILAN)					
ZAMBIA, ESTONIA			I PARI I XHAMISË (pashq.) ISH FUTBOLLISTI SHAQIRI					EMËR MASHKULLI MYSLIMAN BASHKËT.								
PASURITË E PATUNDSHME QË SILLNIN TË ARDHURA (vjet.)						FUTBOLLISTI ANGLEZ ... PARKER (TOTENHAM) GJYMTYRË E TRUPIT								NGASËSI I "Formula 1" ... HAKINEN		
ISH FUTBOLLISTI IGLI					ALFRED KACINARI PJESETAR I AONËVE			MBAJTJE E ANËS TRAJNERI GJERMAN REHAGEL								
INTER		DIREK I ÇATISË SHKRONJA TË NJËJTA				"RODA" RIADI, DAKARI		ISH SOLISTJ ANGLEZE WINEHOUSE (shqip.) OSMAN XHAKA								
EPOKA E RE	KAM NJOHURI PËR DIÇKA ZANORE			QË KA TË BËJË ME ORATORINË OSAKA												
HEROI NË FOTO 3									ZANORE							
3																

Lume's Details
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898
Sallon Depilimi Lume's Details
lumesdetails
Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

C.nr.254/2015

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA RAHOVEC, e përbërë nga gjykatësi Betim Behluli, në çështjen juridike të paditësit Asllan Saliq nga Rahoveci, të cilin e përfaqëson përfaqësuesi i autorizuar avokati Myhedin Beker nga Rahoveci, kundër të paditurit Sllavisha Kollashinac, nga Rahoveci, për shkak të vërtetimit të pronësisë në bazë të fitimit me parashkrim, më 12.04.2019, morri këtë:

AKTVENDIM

Të paditurit Sllavisha Kollashinac nga Rahoveci, i caktohet përfaqësuesi i përkohshëm avokati Zyber Zeka nga Rahoveci.

Arsyetim

Paditësi Asllan Saliq nga Rahoveci, kësaj gjykate i ka ushtruar padinë kundër të paditurit Sllavisha Kollashinac nga Rahoveci, për shkak të vërtetimit të pronësisë në bazë të fitimit me parashkrim.

Në bazë të padisë të paditësit Asllan Saliq, kjo gjykatë ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor me datën 04.04.2019, e meqenëse të gjitha shkresat dhe ftesa janë kthyer me konstatim se i padituri Sllavisha Kollashinac nga Rahoveci gjendet në Serbi me adresë të pa njohur, e në anën tjetër me propozimin e përfaqësuesit të autorizuar të paditësit, gjykata e miratoi propozimin e përfaqësuesit të paditësit dhe të paditurit Sllavisha Kollashinac ia caktoi përfaqësuesin e përkohshëm avokatin Zyber Zeka nga Rahoveci.

Duke marrë për bazë këtë gjendje faktike e duke u mbështetur në dispozitat e nenit 79.3 a) të LPK-së, në anën tjetër duke marrë për bazë natyrën e lëndës urgjente, vendosi që të paditurit t'i caktoi përfaqësuesin e përkohshëm.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA RAHOVEC, C.nr. 254/2015, më, 12.04.2019

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

Prishtinë

Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punës
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë

facebook www.facebook.com/gjejpuneshpeite

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

► Rrahman Saramati shpall te pavlefshme diplomën SHMLT "11 Marsi" Prizren

► Astrit Laske shpall te pavlefshme dëftesat SHMLT "11 Marsi" Prizren

► Shpend Malsori shpall te pavlefshme dëftesat e Kl - IX shf "Bajram Curri" Krushë e Madhe

► Naser Xhimshiti shpall te pavlefshme diplomën SHMLT "11 Marsi" Prizren

► Islam Shala shpall te pavlefshme diplomën SHMLT "11 Marsi" Prizren

► Lirim Kurtaj shpall te pavlefshme diplomën SHMLT "11 Marsi" Prizren

► Liridon Morina shpall te pavlefshme diplomën SHME "Ymer Prizreni" Prizren

► Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

► Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanët me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

► Shitet banesa në Lakërishte përballë Procredit Bankës, hyrja e parë kati i 9 banesa ka 50m2 me dokumentacion të rregullt, çmimi 52 000€. Për info 044/672-439.

► Lëshohet me qira banesa në lakërishte afër Procredit bankës është e mobiluar 50m2 për një çift çmimi është 220€. Për irro 044/672-439.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

► Shes banesën hyrja e 7 mbi kurriz te banesat e gjelbërta përball shkollës "Xhemajl Mustafa" e rinovuar tërësisht. Banesa ka 82 metra katror. 3 dhoma, sallon, shpajz dhe ballkon + taras me shfrytëzim. Çmimi 75000 Euro me para te gatshme, por bej edhe ndërrim me banesë me të vogël në Prishtinë ose banesë më të madhe në Fushë Kosovë sipas marrëveshjes. Numri kontaktues: 044 672 439

► Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.


► Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

► Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

► Lëshohet banesa me qira kati i parë, në rr. Esat Mekuli, çmimi i volitshëm. Për info. 044/ 477-107 Prishtinë. Çmimi shumë i volitshëm dhe është e mobiluar komplet.

► Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.



Shpallje Publike

Bazuar në nenin 8 të Ligjit të Punës, Seksionin V Pikën 3 (c) të Rregullores së KEK-ut Sh.a dhe nevojave të paraqitura për plotësimin e disa vendeve të lira të punës në Divizionet e KEK-ut, Divizioni i Burimeve Njerëzore, më 08.05.2019 publikon ofertën për pozitat e mëposhtme:

1. Teknik të makinerisë (4 Kryerës)

Qëllimi dhe fushëveprimi i vendit të punës:

Bartësi i punës kryen punët e mirëmbajtjes mekanike në kaldaje, salle të makinave, objekte të jashtme dhe servise sipas kërkesave të lëshuara nga inxhinierët përgjegjës të mirëmbajtjes mekanike Respekton udhëzimet për mirëmbajtje, të cilat janë përgatitura nga inxhinierët përgjegjës Kryen preventivat e përgatitura nga inxhinierët përgjegjës me urdhrin e prijësit të ekipit dhe e informon atë për aktivitetet e kryera gjatë preventives dhe ato të cilat kërkojnë ndaljen e pajisjeve. I përgjigjet çdo kohe thirrjes për intervenim dhe të vazhdoj punën sipas nevojë Zbaton të gjitha rregullat e sigurisë. Kryen edhe punë tjera me kërkesën e eporeve të tij

Kërkesat profesionale/ Kualifikimet

Shkolla e Mesme – Teknik i makinerisë. Të jetë i gatshëm të punoj vetëm dhe me ekip. Të dëshmojë aftësitë për të krijuar marrëdhënie të mira pune brenda dhe jashtë organizatës. Nivel të lartë të motivimit, Iniciativë, vendosmëria, intuita dhe vëmendje në detaje. Nivel të lartë të etikës profesionale.

2. Teknik të elektroteknikës (4 Kryerës)

Qëllimi dhe fushëveprimi i vendit të punës:

Bartësi i vendit të punës është i obliguar të punoj sipas urdhërave të cilat i shtron prijësi i ekipit dhe inxhinieri i kryerjes;përpunon dhe vizaton dokumentacionin e nevojshëm për meremetimin e makinave elektrike (motorët, trafote, frejte e tjera) pra të gjitha makinave elektrike. Përgjigjet për kualitetin dhe kuantitetin e punës. Kryen preventivat sipas urdhërave teknologjike dhe i raporton prijësit të ekipit. Është përgjegjës për punën normale të pajisjeve në sistem, ruajtjen dhe mirëmbajtjen e veglave të punës. Përgjigjet për mbajtjen e mjeteve mbrojtëse në punë sipas normave që i kërkon vendi i punës. Elektrotekniku duhet të jetë i vetëdijshëm që gjatë kontrollës-preventives në sistem, shih ose dëgjon ndonjë parregullsi të pajisjes duhet të ndërtoj menjëherë për eliminimin e rrezikut Është i obliguar për raste të veçanta të përgjigjet thirrjes të personelit të prodhimit për evitimin të prishjeve,dhe nëse kërkohe të vazhdoj orarin e punës –vazhdimi bëhet sipas rregullores në fuqi

Kërkesat profesionale/ Kualifikimet

Shkolla e Mesme – Elektroteknike Të jetë i gatshëm të punoj vetëm dhe me ekip. Të dëshmojë aftësitë për të krijuar marrëdhënie të mira pune brenda dhe jashtë organizatës. Nivel të lartë të motivimit, Iniciativë, vendosmëria,intuita dhe vëmendje në detaje. Nivel të lartë të etikës profesionale

3. Administrator Monitorimi ne Qendrën Monitoruese (4 kryerës)

Qëllimi dhe fushëveprimi i vendit të punës:

Bartësi i vendit të punës është përgjegjës për monitorimin e të gjitha objekteve që janë të mbuluara me kamera monitoruese(sistemi monitorues). Për këtë është i obliguar që për çdo ndërrim të mbaje evidencën për të gjitha ngjarjet që mund të ndodhin e të cilat përcjellën nga monitorët. I Raporton Projekt Menaxherit të Kontratës se sigurisë fizike, Menaxherit të Departamentit të Logjistikes dhe Sigurisë Fizike. Në rastet e ndonjë ndodhie kërkon nga Përgjegjësi i OE që të ndërmarrin të gjitha masat e duhura për sigurimin e vendit të ngjarjes, e lajmëron për ndonjë sulm apo rrezik të cilin e vëzhgon në kamerat të cilat e monitorojnë hapësirat KEK-ut. Koordinon punët me Përgjegjësit e OE të sigurisë fizike në Divizione lidhur me çdo rast që ndodh në hapësirat e KEK-ut. Në rast nevojë dhe sipas vlerësimit të situatës e lajmëron edhe Policin e Kosovës. Pranim-dorëzimi i detyrës bëhet në ora 07⁰⁰, 15⁰⁰ dhe 23⁰⁰ gjithësesi në vendin e punës në rastet të mosardhjes vazhdohet edhe në ndërrimin vijues gjegjësisht deri të gjetja e zëvendësimit adekuat.

Me të ardhur në vendin e punës menjëherë kontrollon se a janë në funksion të gjitha pajisjet në qendrën monitoruese. Pastaj bënë verifikimin e librit të raportit të ndërrimit dhe evidencës së monitorimit në monitorë dhe të verifikoi se a janë funksionale pajisjet monitoruese,kamerat vëzhguese, dhe pajisjet tjera në Qendër

Marrëdhëniet: Për punën e vete i përgjigjet Projekt Menaxherit të Kontratës të sigurisë fizike, Menaxherit të Departamentit të Logjistikes dhe sigurisë fizike,

Autorizimet: Është i autorizuar që për çdo ndërrim të mbaje evidencën e të gjitha ngjarjeve që ndodhin në hapësirat e KEK-ut përmes monitorëve(kamerave),sistemin e GPS-ave,sistemin SIMER të rojeve dhe për këtë ta njoftoi Udhëheqësin e ndërrimit, Projekt menaxherin e sigurisë fizike në mënyrë elektronike ndërsa në rast nevojë edhe Policin e Kosovës me telefon kabllovik ose celular .

Kërkesat profesionale/ Kualifikimet dhe aftësitë e duhura:

Të ketë të kryer shkollën e mesme.Përvojë pune 2 vite . Të ketë aftësi organizative dhe komunikuese.Të ketë njohuri të punës me Kompjuter.

4. Zjarrfikës (4 kryerës)

Qëllimi dhe fushëveprimi i vendit të punës:

Bartësi i vendit të punës bënë kryerjen e punëve për mbrojtjen nga zjarri në përputhje me ligjet dhe rregulloret sipas dispozitat ligjore dhe akteve tjera nga kjo lëmi;Gjatë kohës së kujdestarisë, viziton objektin, lokalet, stabilimentet, pajimet dhe pajisjet e posaçërisht vendet të cilat mundet të vjen deri të shpërthimi i zjarrit, për të metat e vërejtura nga shkaktimi i zjarrit, menjëherë duhet të lajmëroj eprorin e vetë dhe në të njëjtën kohë të merr masat e duhura për pengimin e shkaqeve të pa dëshiruara;Gjatë vizitës së objektit të prodhimit dhe hapësirave tjera punuese bënë kontrollimin e pajisjeve kundër zjarrit mbi gjendjes e aftësisë, renditjen e tyre sipas planit dhe merr masa të duhura që çdo herë të jenë në gjendje gatishmërie;Të paralajmëroj punëtorët në objekt për nevojat e mirëmbajtjes dhe masave të parapara për mbrojtjen nga zjarri, në rast se i shih ata që me punën e tyre bëjnë keqpërdorimin e mjeteve të MKZ, edhe krahas paralajmërimit, menjëherë duhet lajmëruar eprorin e tyre;Të njoh dhe gjithëherë të mësoj të gjitha masat për mbrojtjen kundër zjarri sipas planit për mbrojtjen nga zjarri të objektit në Termocentral. Në momentin e pranimit të detyrës të jetë i saktë, i rregullt, fizikisht dhe psikikisht i aftë për kryerjen e punëve dhe detyrave;Që gjatë detyrës të mbaj uniformen e zjarrfikësit, ti ruaj, ti mirëmbaj dhe me qëllim të përdor mjetet mbrojtëse personale me të cilat është i ngarkuar, si dhe në kryerjen e detyrave që bënë në objekt të sillt korrekt me punëtorët dhe me palët tjera;

Marrëdhëniet: Dispeçerit, Prijësit të etazhes,Inxhinieri i ndërrimit,Udhëheqësi i sektorit dhe Menaxherit të Departamentit

Autorizimet: Në rastet emergjente kërkon kyçe – kyçjen e energjisë elektrike ujit. Kërkon deponimin, ngarkimin dhe zbarkimin e materieve të rrezikshme konform Rregullores në fuqi, Kërkon sigurimin e vendeve të rrezikshme nga shpërthimi i zjarrit si dhe largimin e burimeve të zjarrit.

Kërkesat profesionale/ Kualifikimet dhe aftësitë e duhura:

Përgatitja e mesme shkollë , Të jetë nën moshën 30 vjeçare,(Ligji nr. 04/L-49 për zjarrfikje dhe Shpëtim) Të ketë aftësi psiko-fizike për të kryer aktivitetet e zjarrfikëse dhe shpëtimin

5. Saldues (2 kryerës)

Qëllimi dhe fushëveprimi i vendit të punës:

Punon në punët e përgjithshme të saldimit elektrik të llojeve të ndryshme të tegelave pozitive të caktuara të saldimit. Punon sipas urdhërave dhe detyrave që ia parashtron eprori i tij i drejtpërsëdrejti . Mjeshtër i makinerisë dhe Pritsi ndaj të cilëve edhe është përgjegjës për kryerjen e punëve që ia parashtron . Në kryerjen e punëve kryesisht është i pranuar. Bashkëpunon me mjeshterin dhe me Pritsin e makinerisë e me profilet tjera. Kryesisht për punët e kryera bashkëpunon me mjeshterin e mirëmbajtjes dhe Pritsin. Punët e saldimit i kryen në makinat dhe stabilimentet me ç'rast është i pavarur në punë , përpunon rastet të ndërlikuara në të cilat punon. Duhet të njohë mire udhëzimet dhe karakteristikat teknike të mëtutjeshme për saldimit dhe është përgjegjës i drejtpërsëdrejti për punën e vetë. Është i detyruar të njohë mire karakteristikat teknike të saldimit për mohimet dhe stabilimentet si dhe udhëzimet për punë , të bashkëpunon njëjtë me profilet tjera teknike . I zbaton urdhrat dhe detyrat që ia parashtron mjeshterin përgjegjës prijsi i makinerisë. Saldimi me hark elektrik mbushje, pikja, shpuarja dhe zgjerimi i vrimave me hark elektrike . Saldimi i konstruksionit të çelikut, saldimit e gypave të ndryshëm të instalimit që nuk janë të nënshtruar presionit të lartë. Është përgjegjës drejtpërsëdrejti për kualitetin e saldimit të kryer dhe është i pavarësuar në zgjidhjen adekuate të llojit të elektrodës si dhe parametrate tjerë për saldimit elektrik. Kryen edhe punë tjera në lëmin e saldimit sipas aftësive të veta. Ka të drejtë të propozoj mjeshterin e pritjin të remonitit në lidhje me zgjedhjen e problemeve të caktuara në lëmin e saldimit me hark elektrik. Punon edhe punë të tjera sipas kërkesës së udhëheqësit të drejtpërdrejt.

Autorizimet : Është i autorizuar të kërkoj zbatimin e masave mbrojtëse në punë dhe është i obliguar që të përdor mjetet mbrojtëse personale në punë .Është i autorizuar që të refuzoj punën me aparat jo të rregullt për saldimit me hark elektrik në pikëpamje të aftësisë teknike , me mjete dhe vegla të dëmtuara (kablo jo adekuate , të pa izoluar etj) . Është i obliguar ti respektoj orarin e punës ,të punoi edhe jashtë orarit të punës sipas nevojës të posedon ndjenjen e përgjegjësit në punë të konsumimit të materialit dhe mjeteve të punës. **Raportimet;**Drejtpërdrejt i raporton prijësit të ekipit dhe inxhinierit përgjegjës të shërbimit.

Kërkesat profesionale/ Kualifikimet dhe aftësitë e duhura:

Kualifikimi i mesëm. Të jetë i gatshëm të punoj vetëm dhe me ekip. Të dëshmojë aftësitë për të krijuar marrëdhënie të mira pune brenda dhe jashtë organizatës. Nivel të lartë të motivimit, Iniciativë, vendosmëria,intuita dhe vëmendje në detaje. Nivel të lartë të etikës profesionale.

6. Ekspert i lartë për kontrata (1 kryerës)

Qëllimi dhe fushëveprimi i vendit të punës:

Bartësi i vendit të punës respekton dokumentet relevante të Autoritetit Kontraktues, LPP-së, rregulloret e prokurimit publik dhe ligjeve të tjera që janë në fuqi;Përpilon në bashkëpunim me ekspertet tjerë të prokurimit publik Rregulloren për Prokurim Publik, bazuar në dispozitat ligjore në fuqi dhe standardeve ndërkombëtare të pranuar për këtë lëmi, gjegjësisht i përcjell ndryshimet e dispozitave ligjore dhe standardeve ndërkombëtare për këtë lëmi dhe propozon harmonizimin e Rregullores së prokurimit me këto ndryshime. Jep udhëzime dhe ndihmën punëtorët e prokurimit për çështjet që kanë të bëjnë me respektimin e dispozitave ligjore. Me kërkesë të Menaxherit të zyrës së përkrahjes së prokurimit merr pjesë në punën e komisionit për shqyrtimin e ofertave dhe jep udhëzime ligjore, nëse lind nevoja. Përpilon të gjitha llojet e draft kontratave që kanë të bëjnë me furnizime, shitje, shërbime dhe punë të cilat i lidhë KEK-u me afaristët tjerë, Kujdeset që kontratat të jenë në harmoni me dispozitat pozitive në fuqi dhe është përgjegjës për rregullsinë e tyre. Përcjell realizimin e kontratave sa i përket aspektit ligjor dhe jep rekomandime, interpretime ligjore, propozon ndryshimin e kontratave, lidhjen e anekseve të reja etj, nëse paraqitet nevoja. Eksperti i lartë për kontrata është përgjegjës për respektimin e procedurave ligjore dhe për ligjshmërinë e akteve juridike që dalin nga Zyra e prokurimit, dhe rregulloret tjera të KEK-ut. Bashkëpunon ngushtë me institucione tjera si KRPP dhe OSHP. Respekton dokumentet relevante të Autoritetit Kontraktues, LPP-së, rregulloret e prokurimit publik dhe ligjeve të tjera që janë në fuqi; Angazhohet në ngritjen e kualitetit të prokurimit në ZEP; Kontrollon dhe koordinon publikimet dhe komunikimet me KRPP, AQP dhe OSHP, dhe punë tjera në kuadër të përgjegjësisë apo sipas kërkesës.

Përgjegjësitë tjera më të përgjithshme do të përfshijnë:

Sukses efektiv në përfaqësime të KEK sh.a;Ndikimi në zvogëlimin e shpenzimeve gjyqësore për KEK-un sh.a; Është përgjegjës për kryerjen e punëve me profesionalizëm, efikasitet dhe ndershmëri; Vepron në kuadër të autorizimit, por është përgjegjës nëse e bënë tejkalimin e autorizimit; Është përgjegjës për lëshime profesionale, mosdërmarrja e veprimeve të duhura në mbrojtjen e efikasitetit të interesave të KEK sh.a; Është përgjegjës për saktësinë e shënimeve, për arkivimin, ruajtjen e lëndëve gjyqësore Është përgjegjës për respektimin e rregullave të disiplinës në punë, sjelljen korrekte me bashkëpunëtorët, dhe persona të tjerë si brenda KEK sh.a ashtu edhe jashtë tij. **Autorizimet:**Për rezultatet e punës së vete i raporton Menaxherit të Departamentit përkrahjes së prokurimit dhe Drejtorit të zyrës së prokurimit në rastet e caktuara. Të gjitha autorizimet të dhëna me kontratë, përshkrim dhe sipas kërkesës së Menaxherit Departamentit përkrahjes së prokurimit dhe Drejtorit të zyrës së prokurimit.

Kërkesat profesionale/ Kualifikimet dhe aftësitë e duhura:

Kualifikimi universitar – fakulteti juridik, minimum 3 vite përvojë pune profesionale; Provim i jurisprudencës dhe trajnimet nga kjo lami të preferueshme; Njohuri në legjislacion, procedurë gjyqësore dhe administrative

7. Kontrollor i lartë për pune operative (2 kryerës)

Qëllimi dhe fushëveprimi i vendit të punës:

Analizon të gjitha rreziqet financiare dhe rregullisht verifikon përshtatshmërinë dhe funksionimin e kontrolleve të brendshme të KEK-ut. Ofrimin e rekomandimeve specifike për ndryshime dhe përmirësime të kontrolleve të brendshme për të zbutur riskun e regjistrimit të gabuar dhe raportimin e transaksioneve të biznesit, humbjet ose shkatërrimin i pasurive, shpenzimet e tepërta, mashtrimet e kontabilitetit dhe vendim-marrjet e gabuara. Definon llojet dhe teknikat e kontrollit të brendshëm që do të përdoret në çdo rast të Kontrollës, që vepron në bazë të legjislacionit, praktikave më të mira, dhe përvojës dhe njohurive profesionale.

Koordinon gjitha veprimet me Udhëheqësin e Njesisë së kontrollës së brendshme me qëllim që të sigurohet vazhdimësia e funksionimit të ndërmarrjes në mënyrë efektive dhe të rregullt dhe se janë zbatuar objektivat dhe politikat e menaxhimit në përputhje me ligjet dhe rregulloren, mbrojtjen e mjeteve nga vjedhja dhe shpërdorimi. Ndihmën dhe bashkëvepron me kontrollorët për çështje ekonomiko-juridike në drejtim të zbatimit të rekomandimeve dhe masave të kërkuara si rezultat i të gjeturave të kontrollimeve në teren. Të kryejë një vlerësim të pavarur të efektivitetit të politikave, procedurave dhe standardeve, në bazë të cilave Pasurit financiare, fizike dhe burimeve të informacionit të KEK-ut janë duke u menaxhuar. Kontrollimin e koston së kompanisë për të siguruar që ato nuk përfshijnë shpenzimet të cilat janë të paarsyeshme, të panevojshme ose nuk janë në interes të kompanisë.

Përgjegjësitë tjera më të përgjithshme do të përfshijnë:

Tregon integritetin personal dhe profesional në përputhje me kompaninë misionin, vizionin dhe vlerat e saj. Sipas nevojës dhe dyshimit për keqpërdorim kryen kontrole të befasishme pa paralajmërim Përgatit raportet në lidhje me realizimin e objektivave. Detyra dhe caqet tjera që i caktohen kohë pas kohe

Autorizimet: Në përputhshmëri me rregullat e publikuara dhe nivelet e autoritetit.

Kërkesat profesionale/ Kualifikimet dhe aftësitë e duhura:

Kualifikimi universitar – fakulteti ekonomik. Të ketë 3 vite përvojë pune profesionale; Duhet të jetë i aftë për marrjen e vendimeve nën presion të kohës së limituar, në situata komplekse dhe rrethana të paqarta. Qasje sistematike në zgjidhjen e problemeve me aftësi të fokusimit në simptomat e zgjidhjeve drejt zhvillimeve adekuate. Aftësi të shkëlqyeshme vendimmarrëse përmes peshimit të rreziqeve, konsiderimit të opsioneve dhe zgjidhjeve të duhura

8. Inxhinier i xehetarisë (2 kryerës)

Qëllimi dhe fushëveprimi i vendit të punës:

Bartësi i vendit të punës është përgjegjës për operim teknik menaxhim, varësisht ku menaxheri e cakton në kryerjen e punëve. Departamentin përkatës në të cilën caktohet. Është përgjegjës për implementimin e të gjitha masave të

nevojshme për sigurinë në punë dhe prodhim në atë Departament. Menaxhim i tërësishëm i implementimit të prodhimit duke qenë përgjegjës për punët e pranuar nga menaxheri i Departamentit të Djerrinës. Përbushja e planeve teknologjike javore, mujore dhe vjetore për ekskim në Departament dhe raportimi rreth përbushjes së këtyre planeve. Duke udhëhequr me operimin e përditshëm të punës së ekskavatorëve, vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet sigurisë gjeoteknike si në anën e ekskavimit ashtu edhe në zonën e palosjes. Përgjegjës për realizimin e prodhimit në harmoni me mbrojtjen e ambientit dhe sigurisë në punë e prodhim si edhe përmirësimin të vazhdueshëm të sigurisë në punë e prodhim në zonën e tij të përgjegjësisë.

Inxhinieri i xehetarisë sipas nevojës së prodhimit me urdhëresë të menaxherit mund të caktohet në vendet tjera në procesin e prodhimit

Autorizimet: Është personi përgjegjës për kryerjen e punëve në Departament si dhe të gjitha punët përcjellëse rreth tyre sipas urdhëresës së Menaxherit të Departamentit.

Raportimet: Menaxherit të Departamentit të Djerrinës, udhëheqësit sektorëve të xehetarisë

Vartësit e Drejtpërdrejtë : Menaxherit të Departamentit, udhëheqësit sektorëve të xehetarisë

Kërkesat profesionale/ Kualifikimet dhe aftësitë e duhura:

Përgatitja Universitare - Inxhinier i xehetarisë se paku Bachelor

Njohuri të mira të gjuhës angleze dhe njohja e mirë e punës me kompjuter përparësi

Të jetë i gatshëm të punoj vetëm dhe me ekip.

Të dëshmojë aftësitë për të krijuar marrëdhënie të mira pune brenda dhe jashtë organizatës.

Nivel të lartë të motivimit, Iniciativë, vendosmëria, intuita dhe vëmendje në detaje.

Nivel të lartë të etikës profesionale.

9. Inxhinier të makinerisë

(1 kryerës)

Qëllimi dhe fushëveprimi i vendit të punës:

Bartësi i punës i përgjigjet Udhëheqësit të njëjës gjegjëse ku ai caktohet dhe bashkëpunon me inxhinieret tjerë me përvojë me qëllim të ngritjes së njohurive profesionale të tij.

Merr punët nga Udhëheqësi i Njësisë ku aktualisht është i përcaktuar dhe përpunon UP me ndërlikueshmëri të lartë dhe të mesme tekniko teknologjike në bashkëpunim të ngushtë me inxhi përgjegjës.

Bashkëpunon edhe me kolegët e tjerë të Departamentit për realizimin me sukses të punëve që ka marr për sipër.

Përcjell dhe merr pjesë në hartimin e listave defektuese gjithnjë në bashkëpunim të ngushtë me inxhinierin përgjegjës.

Obligohet për zbatimin e metodave të avancuara tekniko teknologjike për aq sa lejojnë kushtet ekzistuese.

Punon dhe përpunon dokumentacionin teknik në formë elektronike ("Auto CAD).

Mban përgjegjësi për punët e kryera nga ana e tij.

Është i obliguar ta ruaj sekretin afarist.

Zbaton dhe respekton rregullat e mbrojtjes dhe sigurisë në punë sipas rregullave dhe ligjit në fuqi.

I kryen dhe i zbaton të gjitha detyrat dhe obligimet të tjera që i urdhërohen nga eprori i tij.

Kërkesat profesionale/ Kualifikimet

Përgatitja superiore - Inxhinier i makinerisë se paku Bachelor

Njohuri të mira të gjuhës angleze dhe njohja e mirë e punës me kompjuter përparësi

Të jetë i gatshëm të punoj vetëm dhe me ekip. Të dëshmojë aftësitë për të krijuar marrëdhënie të mira pune brenda dhe jashtë organizatës. Nivel të lartë të motivimit, Iniciativë, vendosmëria, intuita dhe vëmendje në detaje.

Nivel të lartë të etikës profesionale.

10. Manipulues të shiritave transportues

(5 kryerës)

Qëllimi dhe fushëveprimi i vendit të punës:

Bartësi i vendit është përgjegjës për pastrimin e stacionit kthyes të shiritit në vazhdim dhe shiritit të vetë në gjatësi nga 50 m të dy shiritave transportues, pastrimin e koritës të tamburit shtrëngues dhe gjitha vendeve në konvejerë që pengojnë në procesin e prodhimit. Në rast rreziku për njerëzit ose për pajisjen ,menjëherë e bën shkyqjen e shiritit transportues. Gjatë kontrollimit të pajisjes vëren zhurmë jonormale në motor-reduktor, rrëshqitje të shiritit në tamburet ngasëse, ikje në një anë, grumbullim të materialit, mosfunksionim të fshesave, mosfunksionim normal të ruleve, dëmtim të shiritit, erë me shpejtësi të madhe ,menjëherë e ndërpre punën dhe e lajmëron dispeçerin dhe prijësin

Marrëdhëniet: Dispeçerit, Prijësit të etazhës, Inxhinieri i ndërrimit, Udhëheqësi i sektorit dhe Menaxherit të Departamentit

Autorizimet: Në rast rreziku për njerëzit ose për pajisjen ,menjëherë e bën çkyqjen e shiritit transportues nëse konstaton zhurmë jonormale në motor-reduktor, rrëshqitje të shiritit nga tamburet ngasëse, ikje në një anë, grumbullim të materialit, mosfunksionim të fshesave, mosfunksionim normal të ruleve, dëmtim të shiritit, erë me shpejtësi të madhe .

Në rast rreziku për shiritin ose jetën e tij dhe të tjerëve duhet menjëherë ta ndalë shiritin me anë të një ndërprerësi (pullë-taster) të vendosur në distanca jo të mëdha në shirit transportues për ndalim të dhunshëm dhe për këtë ta njoftojë Dispeçerin dhe Prijësin e etazhes .

Kërkesat profesionale/ Kualifikimet dhe aftësitë e duhura:

Shkolla e Mesme ,Të jetë i gatshëm të punoj vetëm dhe me ekip. Të dëshmojë aftësitë për të krijuar marrëdhënie të mira pune brenda dhe jashtë organizatës. Nivel të lartë të motivimit, Iniciativë, vendosmëria, intuita dhe vëmendje në detaje.

Nivel të lartë të etikës profesionale

Divizioni i Burimeve Njerëzore, fton të gjithë të interesuarit të aplikojnë për pozitat e publikuara

Për hollësitë e mëtejshme për pozitat e lartpërmendura shikoni në faqen e internetit të KEK-ut www.kek-energy.com. Aplikacionet mund të merren në faqen tonë të internetit www.kek-energy.com dhe dërgohen në adresë elektronike ofertapune@kek-energy.com, pranë divizionit të Burimeve Njerëzore në KEK. Aplikimi të behet vetëm në formë elektronike . Format tjera të aplikimit nuk pranohen. Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të parapartë nuk do të pranohen, ndërsa aplikacionet e mangëta refuzohen.

Prishtinë, 08.05.2019

Data e aplikimit deri më 22.05.2019 ora 16:00

Divizioni i Burimeve Njerëzore



NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se shoqëria » SKY NET « SH.P.K., me seli në ZHUR-PRIZREN, ka marrë vendim që ta shuaj Shoqërinë me NRB. dhe NRF. 810082818 me likuidim vullnetar dhe e ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e prodecurës së likuidimit vullnetar.

I njoftojmë të gjithë klientët që kanë raporte kreditore-debitore me këtë shoqëri që të paraqiten në afatin prej 30 ditësh nga data e shpalljes së likuidimit vullnetarë në gazetë.

O B A V E Š T E N J E

Obaveštavamo sve kliente da društvo » SKY NET « D.o.o., sa sedištem u ZHUR-PRIZREN., doneo je odluku o gašenju biznisa sa REG.Br. i FBR. 810082818 putem dobrovolne likuidacije i ujedno imenovao likuidatora o vodjenju postupka dobrovoljne likuidacije.

Obaveštavaju se svi klienti koji imaju potraživanja i obaveze u navedenom društvu, da se jave u roku od 30 dana od dana oglašavanja dobrovoljne likuidacije u novini.

A N N O U N C E M E N T

We inform all clients that the company » SKY NET « L.L.C., based in ZHUR-PRIZREN, has taken the decision to cancel the company with Busines and Fiscal No. 810082818 and with voluntary liquidation and has appointed a liquidator for the development of voluntary liquidation proceeds.

We notify all clients that have credit - debit reports with this company to appear within 30 days from the date of announcement of voluntary liquidation in the newspaper.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 20, pika 2 dhe 4, Kompania "M-Shkodrani" Sh.p.k. Gjilan, në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për qendrën grumbulluese të mbeturinave metalike, automjeteve mbeturinë dhe komponentët e tyre në Shillovë, Gjilan.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 30.05.2019 në ora 11:30 në hapësirat e zyrës së kompanisë "M-Shkodrani" magjistralla Gjilan-Bujanoc do të organizohet debat publik nga kompania "M-Shkodrani" Sh.p.k. Gjilan, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

Debati publik do të organizohet për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për qendrën grumbulluese të mbeturinave metalike, automjeteve mbeturinë dhe komponentët e tyre në Shillovë, Gjilan.

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon në implementimin e projektit.



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol C.JSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

